Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo obrazovanja, nauke,tehnologije i inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

MODUL TRAJNIMI PËR INSPEKTORË TË ARSIMIT

MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË POLITIKAVE ARSIMORE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS, ZBATIMIT TË PLATFORMËS PËR PARANDALIM DHE REAGIM NDAJ BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT

▶ MODUL TRAJNIMI PËR INSPEKTORË TË ARSIMIT

MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË POLITIKAVE ARSIMORE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS,

ZBATIMIT TË PLATFORMËS PËR PARANDALIM DHE REAGIM NDAJ BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT

Modul trajnimi për Inspektorë të Arsimit:
MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË POLITIKAVE ARSIMORE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS, ZBATIMIT TË PLATFORMËS PËR PARANDALIM DHE REAGIM NDAJ BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT

Autorë:

Selim Mehmeti

Design: Envinion

Informacion

Ky modul trajnimi për Inspektorët e Arsimit është përgatitur që të shërbej si material trajnimi për inspektorët e arsimit, me qëllim ngritjen e kapacitetit të tyre lidhur me kërkesat dhe mundësitë e monitorimit të zbatimit të politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijës, adresimin e dhunës në institucionet arsimore, braktisjes dhe mos-regjistrimit nga mekanizmat përkatës, përmes vlerësimit të jashtëm të performancës së shkollës dhe funksioneve tjera të inspektimit.

I jemi mirënjohës Merita Bajraktari-Jonuzi nga MASHTI dhe Lindita Boshtrakaj, Koordinatore Nacionale e Projektit të ILO-së për kontributin e çmuar në të gjitha fazat e përgatitjes së këtij materiali. Gjithashtu, falënderojmë Dëfrim Gashi, Drejtor i Inspektoratit të Arsimit dhe Shyhrete Reçica, Inspektore e Arsimit dhe anëtare e Ekipit për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit (EPRBM) në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH), për bashkëpunimin në organizimin e trajnimit me inspektorët e arsimit.

Moduli i trajnimit mund të përdoret nga Zyra qendrore e Inspektoratit të Arsimit në MASHTI dhe nga Njësia për të Drejta të Njeriut në MASHTI për organizimin e trajnimeve të tjera me IA për këtë temë. Gjithsesi, moduli mund tu shërbej IA për informata shtesë në punën e tyre.

▸ FALËNDERIME

Kjo iniciativë është pjesë e projektit projektit "Masat, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përshpejtimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar (MAP 16)" në mbështetje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) Caku 8.7. Fondet janë mundësuar nga Departamenti i Punës i SHBA-së në kuadër të marrëveshjës së bashkëpunimit me numër IL 30147 16 75 K 11. 100% e të gjitha shpenzimeve të projektit financohen nga fondet federale, në vlerë prej 22,4 million dollarësh, prej të cilave $162,000 janë alokuar për aktivitetet në Kosovë.

▸ NJOFTIM:

Ky material nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose politikat e Departamentit të Punës të Shteteve të Bashkuara, dhe as përmendja e emrave tregtarë, produkteve komerciale ose organizatave nuk nënkupton miratimin nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara.

▶ PËRMBAJTJA

Shkurtesat 8

Pjesa I: Hyrje 9

1.1. Konteksti i përgatitjes së modulit të trajnimit për Inspektorë të Arsimit 10

1.2. Nevojat për këtë modul trajnimi për Inspektoratin e Arsimit 11

1.3. Qëllimi dhe funksioni i modulit 11

1.4. Çfarë përmban moduli për Inspektorët e Arsimit? 13

Pjesa II: Punëtoria me Inspektorë të Arsimit 14

Dita e parë e punëtorisë 16

Dita e dytë e punëtorisë 23

Pjesa III: Materiale plotësuese dhe udhëzime 29

3.1. Problemi i punës së fëmijëve, lidhja e problemit me braktisjen e shkollës dhe cilësinë e arsimit 30

3.2. Korniza e politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë 33

3.3. Kuadri i politikave arsimore për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar 37

3.4. Roli i Inspektoratit të Arsimit, funksionet dhe llojet e inspektimeve 38

3.5. Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës 39

3.6. Vlerësimi i performancës së shkollës - VJPSH 41

3.7. Vlerësimi i performancës së shkollës në fushën e cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor 44

3.8. Instrumentet për mbledhjen e të dhënave 46

3.9. Adresimi i gjetjeve kryesore që lidhen me mbrojtjen e fëmijës në raportet e VJPSH 49

3.10. Mbikëqyrja e zbatimit të politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve, përmes inspektimeve të cilësisë së punës së shkollës dhe inspektimeve tjera nga Inspektorati i Arsimit 50

3.11. Raportet përmbledhëse vjetore të Inspektoratit të Arsimit 52

Pjesa IV: Shtojca 53

Shtojca 1: Roli i institucioneve arsimore në adresimin e punës së fëmijëve - Përmbledhje e raportit për obligimet e institucioneve arsimore për zbatimin e Udhëzimit Administrativ QRK 05/2013 parandalimin dhe ndalimin e formave rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë 54

Shtojca 2: Pjesë nga raporti përmbledhës mbi gjetjet nga monitorimi dhe mentorimi i DKA-ve dhe shkollave, lidhur me funksionimin e EPRBMSH 56

Shtojca 3: Korniza e kritereve të cilësisë së performancës së shkollës 59

Shtojca 4: Listë kontrolli për dështmitë e shkollës lidhur me masat për Parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit 60

Shtojca 5: Formulari me listën e pyetjeve sipas indikatorëve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes 62

Shtojca 6: Përmbledhje e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve në raportet e VJPSH 64

Shtojca 7: Pjesë nga disa raporte të VJPSH, në fushën e cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor 68

Shtojca 8: Korniza ligjore, politika arsimore, si dhe referencat tjera që janë përdorur për zhvillimin e modulit 73

▶ Shkurtesat

▶ BE	Bashkimi Evropian
▶ DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
▶ ECMI	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve
▶ EPRBM	Ekipe për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit
▶ GIZ	Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
▶ IA	Inspektorati i Arsimit
▶ ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
▶ IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
▶ KDF	Konventa e të Drejtave të Fëmijëve
▶ KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
▶ KN	Këshilli i Nxënësve
▶ MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
▶ OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
▶ OJQ	Organizata Joqeveritare
▶ PPRBM	Platforma për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit
▶ PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
▶ QMF	Qendra për Mjekësi Familjare
▶ QPS	Qendra për Punë Sociale
▶ SIA	Sektori i Inspektoratit të Arsimit
▶ SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
▶ SPH	Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm
▶ UA	Udhëzim Administrativ
▶ UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
▶ VJPSH	Vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollës
▶ VPD	Vlerësimi i performancës drejtorit
▶ VPM	Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve

1

HYRJE

1.1 Konteksti i përgatitjes së modulit të trajnimit për Inspektorë të Arsimit

Gjatë dekadës së fundit të arsimit në Kosovë është rritur përqendrimi i institucioneve arsimore në krijimin e kushteve dhe mundësive të barabarta në arsim për të gjithë. Kësaj i ka paraprirë Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) përmes zhvillimit të politikave arsimore dhe krijimit të mekanizmave përkatës, duke u bazuar në përgjegjësitë kryesore që ka për të promovuar sistem jo diskriminues të arsimit, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësit, mbrojtje të grupeve të ndjeshme në kuadër të sistemit të arsimit dhe aftësimit, si dhe për të avancuar masat për parandalimin e braktisjes. Për këtë të fundit, për të avancuar masat për parandalimin e braktisjes së shkollës, MASHTI ka zhvilluar politika arsimore që përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve arsimore, mënyrën e punës dhe adresimin e rasteve të braktisjes dhe mos-regjistrimit të shkollës. Në linjë me këtë, MASHTI ka realizuar disa masa që mbështesin zbatimin e politikave në këtë fushë, si:

- Mbështetja e institucioneve arsimore në themelimin e Ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe Mosregjistrimit në arsimin parauniversitar (EPRBM), nga niveli qendror deri në nivel shkolle;
- Hartimi i doracakëve për shkollat dhe komunat në mbështetje të EPRBM;
- Zhvillimin e Modulit për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) të braktisjes në SMIA;
- Përfshirjen e masave e aktiviteteve të veçanta për parandalimin e braktisjes së shkollës, në Planet strategjike për MASHTI që lidhen me arsimin parauniversitar (si në PSAK, Strategjinë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë, Strategjinë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, etj.).
- Realizimin e projekteve kundër braktisjes me përkrahje nga partnerët që mbështesin arsimin në Kosovë, si UNICEF, ECMI, KEC, GIZ, etj;
- Plane të veprimit dyvjeçare dhe njëvjeçare (plani i veprimit për vitin 2021), me objektiva/caqe, masa/aktivitete dhe tregues përkatës për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës;
- Organizimin tradicional të javës kundër braktisjes, me moton "Mundësi të barabarta në arsim për të gjithë"; Etj.

Në anën tjetër, mbi bazën e dokumentit *Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020*, MASHTI ka zhvilluar dokumentet për sigurim të cilësisë, ka përcaktuar pritshmëritë themelore për çdo shkollë në Republikën e Kosovës dhe ka vendosur sistemin e vlerësimit të performancës së shkollës. Zbatimi i këtyre politikave arsimore lidhen me rolin dhe funksionet e Inspektorati i Arsimit, i cili është organ ekzekutiv qendror për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.

Masat për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit si dhe funksionimi i mekanizimit të EPRBM, janë të integruara edhe në politikat arsimore që lidhen me sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë. Që nga vendosja dhe funksionalizimi i EPRBM në nivel qendror, në nivel komune dhe shkolle, është bërë progres në punën e tyre dhe njëkohësisht janë identifikuar sfida dhe nevoja që duhet të adresohen përmes një procesi të monitorimit institucional për zbatimin e platformës për Parandalim dhe Reagim kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit (PRBM).

Për adresimin e sfidave dhe nevojave të dala gjatë procesit të zbatimit të masave për PRBM, EPRBM në nivel qendror ka hartuar planin dinamik të punës kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës për vitin 2021. Objektiva nr. 1 e këtij plani i referohet ***Fuqizimit të mekanizmave për monitorim, mentorim dhe mbikëqyrje t***ë ***zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes***. Në kuadër të këtij objektivi janë planifikuar punëtori me inspektorët e arsimit. Me qëllim që punëtoritë me inspektorët e arsimit të adresojnë nevojat e organizimit të tyre, është iniciuar përgatitja e këtij moduli, i cili është përgatitur me mbështetje nga Projekti i ILO-së MAP '16.

Përgatitja e modulit përfshiu një analizë të politikave arsimore që lidhen me sigurim të

cilësisë në arsimin parauniversitar, dokumenteve që adresojnë punën e fëmijëve dhe definojnë rolin e institucioneve arsimore në parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve, politikat arsimore që lidhen me mbrojtjen e fëmijës, parandalimin e dhunës në institucione arsimore parauniversitare, masat për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit, një analizë të raporteve në këtë fushë, konsultime me përfaqësues të EPRBM në nivel qendror dhe me inspektorët e arsimit. Mbi këtë bazë, fillimisht është zhvilluar koncepti i modulit të trajnimit, agjenda e punëtorisë dyditore, pastaj në modulin e trajnimit janë reflektuar përmbajtjet sipas temave të përcaktuara.

Duke besuar se ky modul dhe punëtoria dyditore, i plotësojnë nevojat e Inspektorëve të Arsimit dhe do të jenë të dobishme në procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijës, parandalim dhe reagim ndaj dhunës në shkollë, braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin parauniversitar, ne i inkurajojmë Inspektorët e Arsimit që të marrin këtë modul të trajnimit, dokumentet që lidhen me sigurimin e cilësisë së punës së shkollës, dokumentet që lidhen me platformën për PRBM dhe në frymën e praktikave të mira në monitorimin e punës së shkollës dhe ne VJPSH, të fillojnë aktivisht të mbikëqyrin zbatimin e platformës për PRBM.

1.2 Nevoja për një modul të trajnimit të Inspektorëve të Arsimit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për mbrojtje të fëmijës dhe platformës për PRBM

Si rezultat i proceseve të zhvilluara lidhur me punën e EPRBM dhe Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm të braktisjes, brenda Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim, janë shtuar nevojat për monitorim, mentorim dhe mbikëqyrje të zbatimit të platformës së PRBM, në mënyrë institucionale dhe të vazhdueshme.

Duke marrë parasysh rolin dhe përgjegjësitë që ka Inspektorati i Arsimit, si organ ekzekutiv qendror për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, një nga detyrat specifike të inspektoratit pedagogjik lidhur me kontrollimin dhe vlerësimin e punës, arritjeve dhe nevojave të organeve profesionale në institucione arsimore parauniversitare, si dhe duke marrë parasysh kontekstin e llojeve të inspektimeve në arsimin parauniversitar që i realizon inspektorati i arsimit, ka lindur nevoja për zhvillimin e këtij moduli të trajnimit për inspektorë të arsimit.

1.3 Qëllimi dhe funksioni i modulit

Zbatimi i plotë i vlerësimit të jashtëm të performancës së shkollës, respektivisht i mbikëqyrjes së punës së shkollës, përfshirë edhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijës, mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj dhunës në shkollë, braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar, arrihet vetëm kur inspektorët e arsimit:

- Kuptojnë dhe pranojnë plotësisht rolin e tyre në sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe veprimtaritë e lidhura me mbikëqyrjen e institucioneve arsimore parauniversitare kthehen në praktikë pune të mirë koordinuar brenda fushës së veprimtarisë që mbulojnë;
- Njihen me politikat arsimore që referojnë mbrojtjen e fëmijës, masat për parandalim dhe reagim kundër dhunës në shkolla, braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve/nxënësve në arsimin parauniversitar;
- Vlerësojnë rolin dhe ndikimin e mekanizmave të vendosur për mbrojtje të fëmijës, parandalim dhe reagim kundër dhunës, braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve/nxënësve në arsimin parauniversitar;
- Angazhohen vazhdimisht për përmirësimin e proceseve të inspektimit të cilësisë së punës së shkollës drejt ngritjes së cilësisë;
- Angazhohen në një proces të vazhdueshëm të mbledhjes dhe analizës së të dhënave për zbatimin e politikave arsimore për

mbrojtjen e fëmijës, zbatimin e platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar, si bazë për rishikimin dhe plotësimin e masave e politikave arsimore për adresimin e problemeve në këtë fushë, përkrahjes së nevojshme institucionale.

Një nga detyrat e përgjithshme të inspektorëve pedagogjik për sigurimin e cilësisë është: të kontrollojë dhe të vlerësojë funksionimin e këshillave të prindërve, këshillave të nxënësve, këshillave të mësimdhënësve dhe organeve të tjera profesionale. EPRBM janë një nga organet profesionale të cilat themelohen dhe funksionojnë sipas procedurave të përcaktuara me udhëzimin administrativ përkatës. Kjo nënkupton se funksionimi i tyre dhe zbatimi i platformës për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar, i nënshtrohen qasjeve dhe procedurave të inspektimit pedagogjik, inspektimit tematik dhe inspektimeve tjera që organizohet nga Inspektorati i Arsimit.

▶ Ky modul i trajnimit është hartuar me qëllim që kontribuoj dhe përkrah në:

Ngritjen e kapacitetit të inspektorëve të arsimit lidhur me kërkesat dhe mundësitë e monitorimit të zbatimit të politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijës, adresimin e dhunës në institucionet arsimore, braktisjes dhe mos-regjistrimit nga mekanizmat përkatës, përmes vlerësimit të performancës së shkollës dhe inspektimeve tjera të cilësisë së punës së shkollës;

Koordinimin e veprimeve ndërinstitucionale në zbatim të detyrimeve ligjore për mbrojtje të fëmijës, parandalimin e dhunës në institucione arsimore, parandalimin e dhunës në institucione arsimore, parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës;

Vendosjen e një agjende të qartë për monitorimin e politikave arsimore për mbrojtje të fëmijës, parandalimin e dhunës në institucione arsimore, parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, përmes VJPSH, inspektimeve të cilësisë së punës së shkollës dhe inspektimeve tjera që realizohen nga Inspektorati i Arsimit në institucionet arsimore parauniversitare;

◤◤ Gjatë dekadës së fundit të arsimit në Kosovë është rritur përqendrimi i institucioneve arsimore në krijimin e kushteve dhe mundësive të barabarta në arsim për të gjithë.

1.4 Çfarë përmban moduli i trajnimit për Inspektorët e Arsimit?

Moduli *Vlerësimi i jashtëm i shkollës: Mbikëqyrja e zbatimit të politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijës, parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit*, është strukturuar në formatin e një udhëzuesi për realizimin e një punëtorie dyditore me inspektorët e arsimit. E gjithë përmbajtja e modulit është strukturuar në 11 tema, të cilat janë të ndërlidhura në mes vete, referuar qëllimit të modulit dhe përdorimit të tij. Temat janë përqendruar në konceptet kryesore, parimet, proceset dhe strategjitë për sigurim të cilësisë, adresimin e problemit të punës së fëmijëve, mbrojtje të fëmijëve, parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit. Temat janë shoqëruar me burimet për informata shtesë, si dhe me udhëzime praktike për aspektet që lidhen me zbatim VJPSH dhe me mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit.

Temat kryesore që trajtohen në këtë modul dhe të cilat zbërthehen gjatë punëtorisë dy-ditore me inspektorët e arsimit, janë paraqitur në tabelën në vijim.

Nr. rendor i temës	Tema kryesore	Kohëzgjatja/ në punëtori
1.	Problemi i punës së fëmijëve, lidhja e problemit me braktisjen e shkollës dhe cilësinë e arsimit	30 min.
2.	Korniza e politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë	60 min.
3.	Kuadri i politikave arsimore për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar	30 min.
4.	Roli i Inspektoratit të Arsimit, funksionet dhe llojet e inspektimeve	30 min.
5.	Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës	60 min.
6.	Vlerësimi i performancës së shkollës	60 min.
7.	Vlerësimi i jashtëm i shkollës në fushën e cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor	60 min.
8.	Instrumentet për mbledhjen e të dhënave	60 min.
9.	Adresimi i gjetjeve kryesore që lidhen me mbrojtjen e fëmijës në raportet e VJPSH	60 min.
10.	Mbikëqyrja e zbatimit të politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve, përmes inspektimeve të cilësisë së punës së shkollës dhe inspektimeve tjera nga Inspektorati i Arsimit	30 min.
11.	Raportet përmbledhëse vjetore të Inspektoratit të Arsimit	30 min.

Përdorues të këtij moduli të trajnimit do të jenë:

- Inspektorët e Arsimit në nivel qendror / MASHTI
- Inspektorët e Arsimit në SIA
- EPRBM në nivel qendror/MASHTI

Referimi rreth angazhimeve institucionale për parandalim të dhunës në shkollë, parandalim të braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve/ nxënësve në shkollë do ti shërbej fillimit të ndërtimit të bashkëpunimit dhe partneritetit institucional në mbrojtje të fëmijës, në mënyrë të veçantë në adresimin e problemit të braktisjes së shkollës.

2

Punëtoria me Inspektorë të Arsimit

- Temat dhe çështjet kryesore sipas temave
- Rezultatet e pritura për sesione dhe tema
- Metodologjia dhe burimet

Dita e parë e punëtorisë

Sesioni i hapjes së punëtorisë

Hapja e ditës së parë të punëtorisë më inspektorët e arsimit karakterizohet me informacione hyrëse lidhur me kontekstin e organizimit dhe qëllimin e punëtorisë, informimin e pjesëmarrësve për agjendën e punëtorisë. Në sesionin e hapjes së punëtorisë, është planifikuar që pjesëmarrësit të informohen me temat që trajtohen gjatë dy ditëve të punëtorisë, si dhe është planifikuar një prezantim i shkurtër i pjesëmarrësve në punëtori, i cili synon të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të përvojës së pjesëmarrësve në procesin e vlerësimit të jashtëm të shkollës dhe rolit e tyre në mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit.

Kohëzgjatja: 30 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Konteksti i organizimit të punëtorisë; Qëllimi i punëtorisë Agjenda e punëtorisë Prezantimi i pjesëmarrësve dhe pritjeve të tyre	Inspektorët e arsimit e kanë të qartë qëllimin e punëtorisë dhe ar-syeshmërinë e organizimit të saj; Inspektorët e arsimit dhe fasilituesit e punëtorisë pajtohen për temat, agjendën dhe çështjet kryesore që lidhen me organizimin e punëtorisë	Prezantim Reflektime individuale nga pjesëmarrësit Diskutime	Plani dinamik i punës kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës për vitin 2021 Agjenda e punëtorisë

Tema 1: Problemi i punës së fëmijëve, lidhja e problemit me braktisjen e shkollës dhe cilësinë e arsimit

Informacionet përmbledhëse nga kjo temë, kanë për qëllim të ndihmojnë Inspektorët e Arsimit për të kuptuar problemin e punës së fëmijëve, lidhjen e këtij problemi me braktisjen e shkollës dhe cilësinë e arsimit. Gjithashtu, kjo temë ofron edhe informacione për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, diskutime interaktive duke bërë një ndërlidhje se si mund ti shërbej Inspektorati i Arsimit këtij sistemi, përmes mbikëqyrjes së zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit, si dhe raportimit të gjendjes tek mekanizmat përkatës.

Çështjet kryesore që trajtohen në kuadër të kësaj teme, rezultatet e pritura, metodologjia e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Kohëzgjatja: 30 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Problemi i punës së fëmijëve - Si ndikon puna e fëmijëve dhe cilësia e arsimit në braktisjen e shkollës nga fëmijët? Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve - Si mund ti kontribuoj këtij sistemi Inspektorati i Arsimit?	Inspektorët e arsimit, pjesëmarrës në punëtori janë në gjendje të : Përshkruajnë problemin e punës së fëmijëve dhe ndërlidhjen e tij me cilësinë e arsimit, braktisjen e shkollës; Identifikojnë mundësitë dhe veprimet që mund ti ndërmarrin për ti kontribuar sistemit të mbrojtjes së fëmijës, në bazë të rolit që kanë;	Prezantim Diskutime Informata kthyese mbi çështje specifike të ngritura nga inspektorët e arsimit, pjesëmarrës në punëtori lidhur me sistemin e mbrojtjes së fëmijës	Strategjia dhe plani i veprimit për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve në Kosovë 2011 – 2016 (2010) Fëmijët jashtë shkollës – Studim bazë për praktikat e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë (2014); Raporti përmbledhës për obligimet e institucioneve arsimore në Parandalimin dhe eliminimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve (shtojca 1)

Tema 2: Korniza e politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, përmes zhvillimit të politikave arsimore për parandalim dhe reagim kundër dhunës, braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë dhe krijimit të mekanizmave përkatës, bën përpjekje për të promovuar sistem jodiskriminues të arsimit, për të rritur sigurinë dhe mirëqenien e secilit nxënës, mbrojtjen e grupeve të ndjeshme, si dhe angazhohet për të avancuar masat për parandalimin e braktisjes. Në këtë sesion, përmes kësaj teme, synohet një informim më i plotë i inspektorëve të arsimit lidhur me kornizën e politikave arsimore që referojnë masat për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve/nxënësve në arsimin parauniversitar, përmbajtjen e modulit për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) të braktisjes në SMIA, si dhe doracakët e zhvilluar për EPRBM dhe qëllimin e tyre. Brenda konceptit të mbrojtjes së fëmijëve, trajtohet edhe roli i shkollës në zbatim të Protokollit 21/2013 për parandalim dhe referim të dhunës në shkolla, mbrojtja e fëmijëve përgjatë të përdorimit të internetit, si dhe parandalimi i dukurive negative që e sfidojnë pjesëmarrjen e fëmijëve në arsimim dhe zhvillimin e tyre të plotë, si në aspekt fizik, intelektual, emocional dhe social.

Çështjet kryesore që trajtohen në kuadër të kësaj teme, rezultatet e pritura, metodologjia e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Planet strategjike; Protokolli për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar Udhëzimi Administrativ për EPRBM Moduli për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) të braktisjes në SMIA; Doracakët për EPRBM; U.A për mbrojtjen e fëmijëve në internet Pakoja e udhëzuesve për mbrojtjen e fëmiëve në internet	Inspektorët e arsimit, pjesëmarrës në punëtori, marrin informim të plotë lidhur me: kornizën e politikave arsimore që referojnë masat për parandalim të dhunës në shkollë, parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve/nxënësve në arsimin parauniversitar; masat dhe veprimet që janë ndërmarrë nga EPRBMSH në nivel qendror për braktisjen e shkollës; mundësitë e referimit në modulin për SPH dhe doracakët për EPRBM gjatë punës së tyre;	Prezantim Informata kthyese mbi çështje specifike të ngritura lidhur me masat për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve/nxënësve në arsimin parauniversitar Diskutime	Udhëzimi administrativ 08/2018 për krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar Rregullorja QRK- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/rregullore-qrk-nr-21-2013-per-protokollin-per-parandalimin-dhe-referim.pdf Plani dinamik i punës kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës (2021) Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë - Doracakët për ekipet shkollore dhe komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (2014) https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/dora-cak-per-ekipet-shkol-lore-per-parandalim_1.pdf https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/dora-cak-per-ekipet-komu-nale-per-parandalim_1.pdf https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/03/ua-nr-01-2019-per-mbrojtjen-e-femijeve-nxeneseve-ne-int-ne-ins-e-apu.pdf https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/06/libri01-udhe-zuesi-per-klasat-3-5-finali.pdf https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/06/lib02-2-udhe-zuesi-per-klasat-6-9-finali-20-prill-2017.pdf https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/02/lib04-udhe-zuesi-per-mesimdhenes-finali.pdf https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/02/lib03-udhe-zuesi-per-prinder.pdf

Tema 3: Kuadri ligjor për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), në vitet e fundit ka zhvilluar një numër të politikave arsimore që lidhen me sigurimin e cilësisë në parauniversitar, përfshirë pakon e dokumenteve që lidhen me performancën e shkollës, dokumentin e strategjisë së veçantë për sigurimin e cilësisë (2016-2020), integrimin e adresimin e saj në PSAK 2017-2021, udhëzime administrative të veçanta, vendosjen e mekanizmave të veçantë në nivel të institucioneve arsimore për sigurim të cilësisë, etj. Miratimi i Ligjit për Inspektoratin e Arsimit, është një zhvillim tjetër në këtë fushë.

Këto aspekte i mbulon kjo temë, e cila ka për qëllim të udhëzojë pjesëmarrësit lidhur me sistemin për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar, përfshirë legjislacionin bazë dhe dokumentet për sigurimin e cilësisë, funksionimin e mekanizmave për sigurim të cilësisë, si dhe rolin e Inspektoratit të Arsimit në këtë proces.

Tabela e mëposhtme ofron një pasqyrë të çështjeve kryesore që trajtohen lidhur me këtë temë, në kuadër të këtij sesioni, rezultatet e pritura, si dhe orientimet për metodologjinë e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme.

Kohëzgjatja: 30 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Aspektet kryesore që lidhen me sistemin e sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar; Legjislacioni bazë dhe dokumentet për sigurimin e cilësisë; Mekanizmat për sigurim të cilësisë;	Inspektorët e arsimit, pjesëmarrës në punëtori, kanë thelluar të kuptuarit e tyre për: kornizën e politikave arsimore për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar; mekanizmat për sigurim të cilësisë; rolin e inspektoratit të arsimit në këtë proces;	Prezantim Diskutime Informata kthyese mbi çështje specifike të ngritura nga inspektorët e arsimit, pjesëmarrës në punëtori	Ligji për Inspektoratin e Arsimit (2018) Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020 (2015) Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 (2016) Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë (2016); Udhëzimi Administrativ nr. 24/2016: Sigurimi i cilësisë në Arsimin Parauniversitar. Udhëzimi Administrativ nr. 04/2017: Vlerësimi i performancës në Institucionet e Arsimore

Tema 4: Roli i Inspektoratit të Arsimit, funksionet dhe llojet e inspektimeve

Tashmë është e njohur se me Ligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, Inspektorati i Arsimit kryen disa funksione, të cilat i japin dimension të ri punës së Inspektoratit të Arsimit, përkatësisht përgjegjësinë e organit ekzekutiv qendror për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, përfshirë vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, drejtorëve të shkollave dhe vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës. Një nga detyrat e përgjithshme të inspektorëve pedagogjik për sigurimin e cilësisë është: të kontrollojë dhe të vlerësojë funksionimin e këshillave të prindërve, këshillave të nxënësve, këshillave të mësimdhënësve dhe organeve të tjera profesionale. EPRBM në nivel shkolle janë një nga organet profesionale të cilat themelohen dhe funksionojnë sipas procedurave të përcaktuara me udhëzimin administrativ përkatës. Kjo nënkupton se funksionimi i tyre dhe zbatimi i platformës

për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar i nënshtrohen qasjeve dhe procedurave të inspektimit pedagogjik, inspektimit tematik dhe inspektimeve tjera që organizohen nga Inspektorati i Arsimit.

Çështjet kryesore që trajtohen në kuadër të kësaj teme, rezultatet e pritura, metodologjia e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Kohëzgjatja: 20 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Funksionet e Inspektoratit të Arsimit Llojet e inspektimeve të Inspektoratit të Arsimit Roli i IA në mbikëqyrjen e zbatimit të politikave arsimore për mbrojtje të fëmijëve dhe parandalim të braktisjes	Inspektorët e arsimit, pjesëmarrës në punëtori janë në gjendje të: Përshkruajnë rolin e tyre në mbikëqyrjen e zbatimit të politikave arsimore për mbrojtje të fëmijës, parandalimin e dhunës në institucione arsimore dhe të PRBM, përmes qasjeve dhe procedurave të inspektimit pedagogjik, inspektimit tematik dhe inspektimeve tjera që organizohet nga IA; Analizojnë aspektet që lidhen me punën e EPRBM në dokumentet që lidhen me rolin e IA; Identifikojnë situata dhe shembuj praktik kur mund të mbikëqyrin punën e EPRBM, referuar dokumenteve që lidhen me rolin e tyre në sigurimin e cilësisë:	Prezantim Diskutime Informata kthyese mbi çështje specifike të ngritura Punë në çifte Prezantime dhe diskutim i përbashkët.	Ligji për Inspektoratin e Arsimit (2018) Instrumentet e punës së IA për inspektime administrative dhe tematike në institucionet arsimore parauniversitare

Tema 5: Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës – pritëshmeritë e shkollës për mbrojtje të fëmijës, parandalimin e dhunës, mosregjistrimit dhe braktisjes së shkollës

Me Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës, MASHTI përcakton pritshmëritë themelore të shkollës, përmes kritereve të cilësisë dhe treguesve të performancës së shkollës, të cilat shërbejnë si referencë për vlerësimin e performancës së shkollës, planifikimin zhvillimor të saj dhe avancimin e vazhdueshëm të shërbimeve shkollore. Referuar rëndësisë që ka ky dokumenti i Kornizës për sigurim të cilësisë në punën e Inspektoratit të Arsimit për inspektimin e cilësisë së punës së shkollës, përkatësisht procesin e VJPSH, është planifikuar që në këtë sesion të prezantohen dhe diskutohen aspekte që lidhen me qëllimin dhe funksionin e dokumentit të Kornizës për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës, ndërveprimin në mes të parimeve kryesore të KKK, dhe fushave të cilësisë së performancës së shkollës, kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës së shkollës, si dhe fokusin e vlerësimit të performancës së shkollës.

Çështjet kryesore që trajtohen në kuadër të kësaj teme, rezultatet e pritura, metodologjia e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Qëllimi/funksioni i dokumentit; Fushat e cilësisë së shkollës dhe aspektet që mbulojnë; Ndikimin e parimeve të kornizës kurrikulare në kornizën e performancës së shkollës; Kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës së shkollës Konceptet kryesore dhe faktorët ndikues në mosregjistrim dhe braktisje të shkollimit	Inspektorët e arsimit, pjesëmarrës në punëtori, thellojnë të kuptuarit lidhur me: qëllimin dhe funksionin e Kornizës për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës; ndërveprimin në mes të parimeve kryesore të KKK, dhe fushave të cilësisë së performancës së shkollës; aspektet e vlerësimit të performancës së shkollës konceptet kryesore dhe faktorët ndikues në mosregjistrim dhe braktisje të shkollimit	Prezantim Informata kthyese mbi çështje specifike të ngritura lidhur me dokumentin e kornizës Diskutime	Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë (2016); Udhëzuesi për vlerësim të jashtëm të performancës së shkollës (2017) Udhëzimi Administrativ nr. 04/2017: Vlerësimi i performancës në Institucionet e Arsimore

Tema 6: Vlerësimi i performancës së shkollës - VJPSH

Sistemi i vlerësimit të performancës së shkollës integron vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të shkollës, i cili ka karakter zhvillimor për shkollën. Deri sa vlerësimi i brendshëm i shkollës në planin kohor, realizohet çdo vit, vlerësimi i jashtëm realizohet një herë në pesë vite, duke u bazuar në vetëvlerësimet e shkollës dhe planin/et zhvillimor të saj. Informacionet përmbledhëse nga kjo temë, shqyrtimet dhe diskutimet që bëhen me pjesëmarrësit në punëtori, kanë për qëllim të nxisin shkëmbimin e përvojave të inspektorëve të arsimit për VJPSH, duke u thelluar në diskutimin e pyetjeve: Çfarë ka shkuar mirë në VJPSH? Çfarë ka funksionuar apo nuk ka funksionuar? Çfarë është ende e paqartë?, etj.

Çështjet kryesore që trajtohen në kuadër të kësaj teme, rezultatet e pritura, metodologjia e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

> Sistemi i vlerësimit të performancës së shkollës integron vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të shkollës, i cili ka karakter zhvillimor për shkollën.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Thellim i të kuptuarit për: Qasja ndaj vlerësimit të shkollës; Karakteristikat e procesit të vlerësimit të jashtëm të shkollës; Hapat kryesorë të vlerësimit të jashtëm të shkollës; Përvojat e IA në VJPSH: Çfarë ka shkuar mirë, çfarë ka funksionuar, çfarë nuk ka funksionuar, çfarë është ende e paqartë? Përgatitja dhe organizimi i gjetjeve kryesore në raportin e VJPSH;	Inspektorët e arsimit, pjesëmarrës në punëtori janë në gjendje të : Shpjegojnë elementet e qasjes ndaj vlerësimit të shkollës dhe karakteristikat e procesit të VJPSH; Përshkruajnë përvojat në VJPSH; Analizojnë përvojën e VJPSH në ndjekjen e hapave kryesorë për realizimin e vlerësimit; Propozojnë masa dhe veprime konkrete se si ta përmirësojnë dhe avancojnë procesin e dhe raportet eVJPSH	Diskutime Informata kthyese mbi çështje specifike të ngritura Punë në çifte Prezantime dhe diskutim i përbashkët.	Udhëzimi Administrativ nr. 04/2017: Vlerësimi i performancës në Institucionet e Arsimore Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë (2016); Udhëzuesit për VBSH dhe VJPSH (IPK, 2017) Përmbledhje nga Kërkime Pedagogjike (2020)

Dita e dytë e punëtorisë

Hapja e ditës së dytë të punëtorisë

Ditës e dytë e punëtorisë fillon me një përmbledhje të temave të trajtuara në ditën e parë, reflektim/ interaktivitet me pjesëmarrësit lidhur me çështjet e trajtuara, informacione shtesë për çështjet që mund të ketë paqartësi, etj. Pastaj, për pjesëmarrësit rikujtohen për agjendën e ditës dhe temat që do të trajtohen sipas sesioneve të punëtorisë së planifikuar.

Kohëzgjatja: 30 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Përmbledhje e ditës paraprake të punëtorisë Prezantimi i agjendës së ditës	Pjesëmarrësit rikujtojnë çështjet kryesore që janë trajtuar gjatë ditës paraprake; Pjesëmarrësit e kanë të qartë ndërlidhjen e çështjeve të trajtuara me agjendën e planifikuar për ditën e dytë	Prezantim Reflektime individuale nga pjesëmarrësit Diskutim	Prezantimi Agjenda e punëtorisë / dita e dytë

Tema 7: Vlerësimi i performancës së shkollës në fushën e cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor

Kjo teme përqendrohet në aspektet kryesore që lidhen me vlerësimin e jashtëm të shkollës në fushën e cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor, duke nxitur shkëmbimin e përvojave të inspektorëve të arsimit në këtë fushë, gjithnjë në ndërlidhje me praktikën e mbikëqyrjes së punës së EPRBM përmes vlerësimit të kësaj fushe të cilësisë, kritereve të cilësisë së saj dhe treguesve të performancës. Gjithashtu, kjo temë ofron informata dhe shembuj të veprimeve që mund të ndërmerren nga inspektorët e arsimit gjatë VJPSH në këtë fushë të cilësisë, për të siguruar mbikëqyrjen e platformës për PRBM.

Çështjet kryesore që trajtohen në kuadër të kësaj teme, rezultatet e pritura, metodologjia e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Përvojat në vlerësimin e aspekteve të kërkuara në këtë fushë; Çfarë është bërë dhe si është bërë lidhur me punën e EPRBM? Përgatitjet nga IA për mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për PRBM gjatë procesit të VJSH – në fushën e cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor; Si duhet referuar kritereve të cilësisë dhe treguesve të performancës në ndërlidhje me sigurimin e dëshmive për funksionimin dhe punën e EPRBM? Si të zhvillohen instrumente apo kërkesa të veçanta për këtë qëllim?	Inspektorët e arsimit, pjesëmarrës në punëtori: Shkëmbejnë përvojat për qasjet që kanë ndjekur në vlerësimin e fushës së cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor (vlerësimin e kritereve të cilësisë dhe treguesve të performancës), treguesve të performancës që lidhen me EPRBM; Shfrytëzojnë praktikat e mira për të dhënë ide rreth përgatitjeve për mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për PRBM gjatë procesit të VJSH – në fushën e cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor; Përdorin treguesit e performancës që lidhen me EPRBM për të vendosur për instrumentet që do ti zhvillojnë për mbikëqyrjen e platformës për PRBM;	Reflektime individuale nga pjesëmarrësit Diskutime të strukturuara Prezantim Punë individuale dhe në çifte	Udhëzuesi për vlerësim të jashtëm të performancës së shkollës (2017) *Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë - Doracakët për ekipet shkollore dhe komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obligoar (2014)* Pjesë nga disa raporte të VJPSH, në fushën e cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor (shtojca nr.7)

Tema 8: Instrumentet për mbledhjen e të dhënave për VJPSH

Tema ofron një pasqyrë të shkurtër të veprimeve që duhet ndërmarrë për përgatitjen e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave për VJPSH, sistemimin e tyre në formularë të veçantë sipas fushave të cilësisë, përgatitjen e pyetjeve/kërkesave apo përshkrimeve për mbledhjen e të dhënave, mbledhjen e të dhënave dhe analizën e tyre. Mbi këtë bazë, së bashku me pjesëmarrësit shqyrtohen instrumentet për identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve në rrezik të braktisjes dhe fëmijëve jashtë shkolle, shqyrtimi behët nga perspektiva për mbledhjen e të dhënave që lidhen me mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për PRBM. Shqyrtimi do të fokusohet në atë se çfarë duhet të përmbajnë instrumentet për mbledhjen

e të dhënave, me cilët akterë duhet të përdoren instrumentet për mbledhjen e të dhënave, si duhet të përdoren dhe si të integrohen gjetjet në instrumentin e VJPSH.

Çështjet kryesore që trajtohen në kuadër të kësaj teme, rezultatet e pritura, metodologjia e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Analiza e instrumenteve të përdorura për VJPSH, pjesëve të instrumenteve që referojnë mbledhjen e të dhënave për parandalimin e dhunës, braktisjes, punën e EPRBM; Instrumentet për identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve në rrezik të braktisjes dhe fëmijëve jashtë shkolle Zhvillimi i instrumenteve dhe mbledhja e të dhënave lidhur me zbatimin e platformës për PRBM; Moduli për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) të braktisjes në SMIA	Inspektorët e arsimit, pjesëmarrës në punëtori janë në gjendje të: Tregojnë për praktikën e mbledhjes së të dhënave gjatë VJPSH - për punën e EPRBM; Familjarizohen me instrumentet për identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve në rrezik të braktisjes dhe fëmijëve jashtë shkolle; Rishikojnë modelin e një instrumenti ilustrues për mbledhjen e të dhënave lidhur me EPRBM: Ofrojnë shembuj të dëshmive për mbledhjen e të dhënave në instrumentin e VJPSH;	Diskutim i përbashkët lidhur me instrumentet e përdorura për VJPSH Rishikimi individual i një instrument që lidhet me punën e EPRBM. Punë në çifte Diskutim i strukturuar	Udhëzuesi për vlerësim të jashtëm të performancës së shkollës (2017) Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë - Doracakët për ekipet shkollore dhe komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (2014) Moduli për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) të braktisjes në SMIA Instrumentet në shtojcat 4 dhe 5 të këtij moduli.

Tema 9: Adresimi në raport i gjetjeve kryesore që lidhen me parandalimin e dhunës dhe parandalimin e braktisjes së shkollës në raportet e VJPSH

Kjo temë përqendrohet në raportin e VJPSH, me fokus të veçantë në gjetjet kryesore nga VJPSH, organizimin e tyre sipas niveleve të vlerësimit, përmbledhjen e anëve të forta dhe sfidave kryesore, duke u përqendruar më shumë në adresimin e gjetjeve kryesore që lidhen me zbatimin e platformës për PRBM. Gjithashtu, kjo temë trajton aspektet që lidhen me diskutimin e raportit të VJPSH me udhëheqjen dhe akterët tjerë të shkollës, si dhe veprimet që duhet ndërmarrë nga inspektorët e arsimit për informim të mekanizmave që lidhen me zbatimin e platformës për PRBM, për gjetjet kryesore në këtë fushe dhe për masat që duhet ndërmarrë në adresimin e problemeve të identifikuara.

Çështjet kryesore që trajtohen në kuadër të kësaj teme, rezultatet e pritura, metodologjia e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Organizimi i gjetjeve kryesore që lidhen me parandalimin e dhunës në shkollë, zbatimin e platformës për PRBM; Konstatimi i gjendjes - Çka duhet të përmbajë raporti i VJPSH lidhur me parandalimin e dhunës, zbatimin e platformës për PRBM? Diskutimi i raportit, shqyrtimi i tij në nivel shkolle dhe në nivel të komunës; Kur duhet të bëhet dhe si?	Inspektorët e arsimit, pjesëmarrës në punëtori: Shkëmbejnë përvojat për përgatitjen dhe organizimin e raportit përmbledhës për VJPSH; Shfrytëzojnë praktikat e mira për të dhënë ide rreth organizimit në raportin e VJPSH të gjetjeve kryesore që lidhen me zbatimin e platformës për PRBM ;	Prezantim Diskutime Informata kthyese mbi çështje specifike të ngritura Punë në çifte Prezantime dhe diskutim i përbashkët.	Udhëzuesi për vlerësim të jashtëm të performancës së shkollës (2017) Raport përmbledhës mbi gjetjet nga monitorimi dhe mentorimi i DKA-ve dhe shkollave, lidhur me funksionimin e EPRBMSH (2017) https://www.childrights-ks.org/site/assets/files/1408/raporti_monitorues_mbi_funksionimin_e_eprbmsh_a5.pdf Përmbledhje nga Kërkime Pedagogjike (2020)

Tema 10: Mbikëqyrja e zbatimit të politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve, përmes inspektimeve të cilësisë së punës së shkollës dhe inspektimeve tjera nga IA

Tema ofron një pasqyrë të shkurtër të veprimeve që duhet ndërmarrë për mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit përmes inspektimit pedagogjik, inspektimit të cilësisë së punës dhe vlerësimit të performancës së drejtorit dhe zëvendësdrejtori, si dhe të mësimdhënësve; inspektimit tematik, ri-inspektimit. Pastaj, shqyrtohen aspektet që lidhen me përgatitjet e IA për mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për PRBM përmes inspektimeve tjera të cilësisë së punës së shkollës, shqyrtimin e raporteve nga moduli i Sistemit për Paralajmërim të Hershëm (SPH) në SMIA dhe elementet që duhet të përmbajë plani i veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit platformës për PRBM.

Çështjet kryesore që trajtohen në kuadër të kësaj teme, rezultatet e pritura, metodologjia e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tema ofron një pasqyrë të shkurtër të veprimeve që duhet ndërmarrë për mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit përmes inspektimit pedagogjik, inspektimit të cilësisë së punës dhe vlerësimit të performancës së drejtorit dhe zëvendësdrejtori, si dhe të mësimdhënësve; inspektimit tematik, ri-inspektimit.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Inspektimet administrative dhe tematike për zbatimin e politikave arsimore që lidhen me mbrojtjen e fëmijës; Inspektimet lidhur me cilësinë e punës së shkollës; Përgatitjet e IA për mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për PRBM përmes inspektimeve tjera të cilësisë së punës së shkollës;	Inspektorët e arsimit, pjesëmarrës në punëtori janë në gjendje të: Qartësojnë mundësitë e mbikëqyrjes së zbatimit të platformës për PRBM përmes inspektimeve të cilësisë së punës së shkollës dhe inspektimeve tjera; Vendosin për përgatitjet që duhet bërë për mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për PRBM përmes inspektimeve tjera të cilësisë së punës së shkollës;	Prezantim Reflektime individuale nga pjesëmarrësit Punë individuale dhe në çifte Diskutime të struk-turuara	*Ligji për Inspektoratin e Arsimit (2018)* *Standardet për praktikën profesionale për drejtorët e shkollave në Kosovë (2012)* Korniza strategjike për zhvillimin e mësim-dhënësve në Kosovë (2017)

Tema 11: Raportet përmbledhëse vjetore të Inspektoratit të Arsimit

Kjo temë përqendrohet në aspektet kryesore që lidhen me raportet përmbledhëse vjetore të Inspektoratit të Arsimit. Fokusi do të jetë në përgatitjen e raporteve përmbledhëse vjetore që IA duhet ti nxjerrë lidhur me zbatimin e platformës për PRBM, duke përfshirë konstatimin e gjendjes në zbatimin e platformës që lidhet me PRBM, faktorët që kanë ndikuar në nivelin e zbatimit të platformës që lidhet me PRBM, vlerësimin për ndikimin e masave për PRBM, raportimin tek mekanizmat institucional përkatës, planifikimin e masave për përmirësim dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre.

Çështjet kryesore që trajtohen në kuadër të kësaj teme, rezultatet e pritura, metodologjia e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Kohëzgjatja: 30 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Raportet përmbledhëse vjetore të Inspektoratit të Arsimit; Konstatimi i gjendjes në zbatimin e platformës që lidhet me PRBM; Identifikimi i faktorëve që kanë ndikuar në nivelin e zbatimit të platformës që lidhet me PRBM; Raportimi te mekanizmat institucional përkatës; Planifikimi i masave për përmirësim; Mbikëqyrja e vazhdueshme e zbatimit dhe ndikimit të masave të planifikuara;	Inspektorët e arsimit, pjesëmarrës në punëtori janë në gjendje të: Konkretizojnë aspektet kryesore që duhet të përfshihen në raportin përmbledhës vjetor të IA lidhur me zbatimin e platformës për PRBM; Përshkruajnë shembuj ilustrues të konstatimeve të përgjithshme të gjendjes në zbatimin e platformës për PRBM, faktorët që kanë ndikuar dhe propozojnë masa për përmirësim; Përgatisin një plan orientues për informimin e mekanizmave përkatës lidhur me zbatimin e platformës për PRBM;	Prezantim Reflektime individuale nga pjesëmarrësit Punë individuale dhe në çifte Diskutime të struk-turuara	*Ligji për Inspektoratin e Arsimit (2018)* Udhëzuesi për vlerësim të jashtëm të performancës së shkollës (2017) Raport përmbledhës mbi gjetjet nga monitorimi dhe mentorimi i DKA-ve dhe shkollave, lidhur me funksionimin e EPRBMSH (2017)

Sesioni përmbyllës i punëtorisë

Sesioni përmbyllës punëtorisë më inspektorët e arsimit karakterizohet me reflektime individuale nga përvojat dhe mësimet e marra gjatë punëtorisë, konstatime përmbyllëse lidhur me përmbushjen e qëllimit të punëtorisë dhe rezultateve të pritura. Gjithashtu, në këtë sesion rikthehet diskutimi për planin dinamik të punës kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës për vitin 2021 dhe për hapat e mëtojë që do ti ndërmarrë Inspektorati i Arsimit për mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit.

Kohëzgjatja: 30 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Hapat e mëtejmë Plani dinamik i punës për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e performancës së shkollës në mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e braktisjes për vitin 2021 Konstatimet përmbyllëse	Inspektorët e arsimit, pjesëmarrës në punëtori janë në gjendje të: Vendosin për hapat që do ti ndërmarrin në mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për PRBM përmes planit për VJPSH; Prezantojnë mësimet nga punëtoria dyditore;	Prezantim Reflektime individuale nga pjesëmarrësit Diskutim	Konstatimet përmbyllëse Plani dinamik i punës kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës për vitin 2021

3

Materiale plotësuese dhe udhëzime

3.1 Problemi i punës së fëmijëve, lidhja e problemit me braktisjen e shkollës dhe cilësinë e arsimit

Referuar Ligjit për Mbrojtje të Fëmijëve puna e fëmijëve është puna që dëmton mirëqenien e fëmijës dhe pengon arsimin dhe zhvillimin e tij ose saj si dhe standardin e ardhshëm jetësor. Puna e fëmijëve është punë e cila për nga natyra dhe/ose mënyra si kryhet, dëmton, abuzon dhe shfrytëzon fëmijën dhe i mohon të drejtën e fëmijës për arsimim.

Faktorët që shkaktojnë punën e fëmijëve që përshkruhen në raporte dhe dokumente të ndryshme, kryesisht lidhen me gjendjen ekonomike, arsimin dhe normat sociale. Të tre këta faktorë lidhen me faktorët e rrezikut për mosregjistrim, mosvijim dhe braktisje të shkollës të identifikuar dhe përshkruar në doracakët për EPRBM, ata janë: faktorët familjarë, faktorët shkollorë dhe faktorët socialë.

Edhe në dokumentin Strategjia dhe plani i veprimit për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve në Kosovë 2011 – 2016 (2010), angazhimi në punë i fëmijëve/ nxënësve braktisës dhe performanca e ulët e nxënësve, renditën ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në braktisje të shkollimit. Sipas kësaj strategjie, ***përpjekja për të siguruar arsim cilësor dhe për të gjithë fëmijët është bazë e të gjitha përpjekjeve për eliminimin e punës së fëmijëve***.

Prandaj është e rëndësishme që Inspektorati i Arsimit, gjegjësisht inspektorët të cilët mbikëqyrin zbatimin e platformës për PRBM:

- të informohen dhe thellojë të kuptuarit e tyre lidhur me problemin e punës së fëmijëve dhe ndërlidhjen e tij me cilësinë e arsimit, braktisjen e shkollës;
- të këtë listën e institucioneve që kanë role dhe përgjegjësi në adresimin e punës së fëmijëve dhe të intensifikojë bashkëpunimin institucional për informim reciprok dhe koordinim të veprimeve;
- të realizojnë proces cilësor të vlerësimit të jashtëm të performancës së shkollës, në mënyrë që të përmbushin rolin e inspektoratit të arsimit si një mekanizëm qëndror për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, si dhe
- të identifikojnë mundësitë dhe veprimet që mund ti ndërmarrin për ti kontribuar sistemit të mbrojtjes së fëmijës, në bazë të rolit që kanë;

Format më të këqija të punës së fëmijëve

Dimensioni i përcaktimit të formave më të këqija të punës së fëmijëve buron nga Konventa 182 e ILO-së për Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve dhe nga politikat shtetërore për mbrojtjen e fëmijës. Referuar këtyre dokumenteve, inspektorët e arsimit duhet të njohin format më të këqija të punës së fëmijëve, në mënyrë që gjatë monitorimit të zbatimit të politikave për mbrojtjen e fëmijës nga institucionet arsimore, ti kenë për bazë dhe ti referohen atyre gjatë inspektimeve në shkolla lidhur me këtë fushë.

Format më të këqija të punës së fëmijëve:

a. të gjitha format e skllavërisë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, të tilla si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, detyrimi skllavërues dhe bujkrobëria dhe puna pa dëshirë ose e detyruar, përfshirë rekrutimi pa dëshirë ose të detyruar për përdorim në konflikte të armatosura;

b. përdorimin, kërkimin ose dhënien e një fëmije për prostitucion, për prodhim pornografie ose për shfaqje pornografike;

c. përdorimin, kërkimin ose dhënien e një fëmije për veprimtari të paligjshme, në veçanti për prodhimin dhe trafikimin e drogave narkotike sikundër janë përkufizuar në traktatet përkatëse ndërkombëtare;

d. punët të cilat, nga natyra ose rrethanat në të cilat kryhen mund të rrezikojnë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve.

Format e rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë

Kategoria e katërt (d) cilësohet si punë e rrezikshme e fëmijëve dhe i referohet punës që ka gjasa të rezultojë në vdekjen e fëmijës,

lëndimin (shpeshherë për gjithë jetën) ose sëmurjen (shpeshherë për gjithë jetën) për shkak të natyrës së punës ose si pasojë e vendit jo të sigurt të punës, standardeve të ulëta të sigurisë dhe shëndetit dhe kushteve dhe rregullimeve të punës. Sa i përket kësaj kategorie, versioni i parë i listës së punëve të rrezikshme për fëmijë në Kosovë është përgatitur me mbështetjen e ILO-së gjatë periudhës 2005-2007, dhe ka hyrë në fuqi ligjërisht si Udhëzim Administrativ i Qeverisë për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rrezikshme për Fëmijë në Kosovë (UA 17/2008). Udhëzimi Administrativ rendit (a) sektorët e rrezikshëm dhe (b) aktivitetet e përgjithshme të rrezikshme që duhet të ndalohen si çështje parësore. Në vitin 2013, UA 17/2008 u zëvendësua me UA 05/2013, duke përditësuar listën e punëve të rrezikshme për fëmijë në Kosovë. Referuar UA 05/2013, aktivitetet e përgjithshme për ndalim të menjëhershëm janë si në vijim:

- Puna e natës (20:00 deri 06:00);
- Ngritja dhe bartja e peshave të rënda (ngritje dhe bartje e kohëpaskohshme mbi 15 kg për djem dhe mbi 10 kg për vajza; ngritje dhe bartje e vazhdueshme mbi 10 kg për djem dhe mbi 5 kg për vajza;
- Puna në thellësi, nën sipërfaqe të tokës, nën ujë dhe mjedise të mbyllura
- Puna në lartësi (mbi 2 m);
- Ekspozimi ndaj temperaturave ekstreme, ndaj zhurmës dhe dridhjes;
- Ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme (toksike, biologjike, radioaktive, kancerogjene, pluhurit dhe gazrave);

Sektorët për ndalim të menjëhershëm

- Puna në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë
- Puna në rrugë
- Puna në deponi të mbeturinave
- Puna në eksploatimin e pasurive natyrore
- Puna në ndërtimtari

> Referuar Ligjit për Mbrojtje të Fëmijëve puna e fëmijëve është puna që dëmton mirëqenien e fëmijës dhe pengon arsimin dhe zhvillimin e tij ose saj si dhe standardin e ardhshëm jetësor.

Barrierat e qasjes në arsim

Në raportin përmbledhës lidhur me përmbushjen e obligimeve për zbatimin e UA 05/2013 për Parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë, të përgatitur nga Koordinatorja për të Drejta të Njeriut në MASHTI, me përkrahje nga ILO, janë shpalosur disa barriera të qasjes në arsim, si:

- Kushtet e vështira ekonomike në familje;
- Mungesa e shërbimeve profesionale në shkolla;
- Distanca e shkollave në vendet rurale (mungesa e transportit të organizuar);
- Mungesa e sigurisë gjatë rrugës në shkollë;
- Dhuna në shkollë;
- Prezenca e lokaleve në afërsi të shkollës;
- Qasja afirmative ndaj punës së fëmijëve dhe mungesa e vetëdijes për efektet negative në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës;
- Mungesa e bashkëpunimit të shkollës me institucionet e mirëqenies sociale për trajtimin e rasteve të fëmijëve të përfshirë në punë;
- Angazhimi i pamjaftueshëm i Drejtorive Komunale të Arsimit dhe mekanizmave relevant për adresimin e braktisjes së shkollës dhe punës së fëmijëve;

- Cilësia e Arsimit (kurrikula e stërngarkuar, metodologjia joadekuate e punës me nxënës, mungesa e mjeteve mësimore dhe infrastrukturës së përshtatshme shkollore, punë me ndërrime).

Identifikimi barrierave të qasjes në arsim është vetëm një hap drejt adresimit të tyre nga institucionet që kanë role dhe përgjegjësi në këtë fushë. Pa dyshim, roli institucioneve arsimore në adresimin e punës së fëmijëve është i rëndësisë së veçantë. Në këtë mes hyjnë në radhë të parë MASHTI, pastaj DKA, Shkollat dhe Inspektorati i Arsimit. Dy perspektiva të trajtimit të punës së fëmijëve nga institucionet arsimore:

- Puna e fëmijëve si shkak i braktisjes;
- Puna e fëmijëve si pasojë e cilësisë së dobët të arsimit.

MASHT në fund të vitit 2013 (24.12.2013), ka miratuar raportin përmbledhës lidhur me obligimet e institucioneve arsimore (MASHTI, DKA dhe shkollat për zbatimin e Udhëzimit Administrativ QRK 05/2013 parandalimin dhe ndalimin e formave rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë. Shih shtojcën nr.1. në këtë modulit të trajnimit.

Inspektorati i Arsimit, si mekanizëm qendror për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, ka përgjegjësi të veçanta për monitorimin e politikave që lidhen me mbrojtjen e fëmijës, monitorimin e braktisjes së shkollës dhe proceseve që zhvillohen në institucione arsimore, me qëllim vlerësimin e cilësisë në arsim, prandaj kjo temë është trajtuar në kuadër të këtij moduli të trajnimit me inspektorët e arsimit.

3.2 Korniza e politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë

E drejta në edukim tanimë është ripohuar disa herë që nga koha kur ishte shpallur për herë të parë në vitin 1948 përmes Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), më vonë e konkretizuar në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve (KDF) në nenet 28 dhe 29. Këto traktate deklarojnë që të paktën arsimi fillor është falas dhe i detyrueshëm, ndërsa arsimi i mesëm dhe i lartë do të bëhen në mënyrë progresive të arritshme për të gjithë, edhe pse jo domosdoshmërish falas. Neni 28 i KDF përcakton edukimin si e drejtë dhe rekomandon hapat për të arritur këtë të drejtë "në mënyrë progresive dhe mbi bazën e mundësive të barabarta". Referuar këtyre përcaktimeve, nga sistemet arsimore kërkohet që të ndërmarrin hapat si në vijim[1]:

- Arsimi fillor duhet të jetë i detyrueshëm dhe falas për të gjithë;
- Arsimi i mesëm duhet të vihet në dispozicion dhe të jetë i arritshëm për çdo fëmijë, me ndihmën financiare në rast nevoje.
- Të inkurajojnë vijimin në shkollë dhe zvogëlimin e normës së braktisjes.

Dokumentet bazë që e rregullojnë arsimin parauniversitar në Kosovë, si Ligji për arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011) dhe Korniza e Kurrikulës së Arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës (2011/ e rishikuar 2016), janë të ndërtuara mbi parimin e gjithëpërfshirjes në arsim, që në mënyrë të drejtpërdrejtë i referohet së drejtës së secilit fëmijë dhe të ri për përfshirje të barabartë në arsim cilësor. Referuar Ligjit për arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës, arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj[2].

E drejta e secilit fëmijë dhe të ri për përfshirje të barabartë në arsim cilësor, obligon institucionet arsimore nga niveli qendror deri të shkolla që të ndërmarrin masa për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar. Në këtë drejtim, MASH ka hartuar bazë legjislative për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar, përfshirë akte nënligjore, vendosje të mekanizmit të EPRBM nga niveli qendror deri në nivel shkolle, doracakë dhe dokumentacion shoqërues mbështetës për punën e EPRBM dhe për paralajmërim të hershëm të braktisjes në SMIA.

Aspektet e zbatimit në praktikë të masave për parandalim dhe reagim kundër dhunës në institucione arsimore, braktisjes dhe moregjistrimit, janë adresuar edhe me plane strategjike, si në:

- PSAK 2011-2016 & PSAK 2017-2021;
- Strategjinë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë,
- Strategjinë për riintegrimin e personave të riatdhesuar;
- Protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar;
- Udhëzuesi për zbatimin e Rregullores së QRK-nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar[3];
- Planin e veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, etj.

1 Më gjerësisht, shih Modulin 1: E Drejta për Edukim - Edukimi Cilësor. Programi për ngritjen e kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore,

2 Instituti Pedagogjik i Kosovës (2014). Fëmijët jashtë shkollës – Studim bazë për praktikat e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë.

3 Protokolli është fryt i koordinimit ndërinstitucional. Protokolli mundëson:
Qasjen ndërinstitucionale dhe multidimensionale
Konsolidimin e sistemin të raportimit dhe referimit të rasteve
Orientimin e politikave bazuar në dëshmi

Bazuar në planet strategjike, janë zhvilluar plane të veprimit dhe janë realizuar një mori e aktiviteteve dhe projekteve lidhur me parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimin e fëmijëve në arsimin parauniversitar, përfshirë themelimin dhe koordinim e aktiviteteve me EPRBM nga niveli qendror deri në nivel të shkollës.

Krahas themelimit të EPRBM, MASH ka mbështetur ngritjen e kapaciteteve të tyre me përkrahje nga partnerët që mbështesin arsimin në Kosovë, si UNICEF, ECMI, KEC, GIZ, përmes trajnimeve, punëtorive dhe udhëzuesve për EPRBM në nivel shkolle dhe komune. EPRBM në nivel nacional ka mbështetur komunat dhe shkollat duke mentoruar e këshilluar në lidhje me funksionimin sa më të mirë të ekipeve të tyre në bashkëveprimin me sektorët tjerë në nivele komunale (QMF, QPS, PK, KPAK, KPA, KN, dhe OJQ,)

Me qëllim të koordinimit më të mirë dhe arritjes së rezultateve në parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit të shkollës, MASH në bashkëpunim me UNICEF ka zhvilluar modulin e Sistemit për Paralajmërim të Hershëm (SPH) në kuadër të Sistemit të menaxhimit të informatave në arsim (SMIA). Zhvillimi i këtij moduli u mundëson shkollave /EPRBM që ti identifikojnë fëmijët që janë në rrezik të braktisjes së shkollës, ti raportojnë rastet dhe në varësi të faktorëve ndikues të ndërmarrin masa parandaluese.

Krahas udhëzuesve për EPRBM, Modulit për Sistemin për Paralajmërim të Hershëm (SPH), janë hartuar edhe manualet didaktike, si:

- Manuali didaktik për parandalimin e dhunës në shkolla
- Manuali për parandalim të dukurive negative në shkolla të mesme të larta
- Udhëzuesit për mbrojtjen e fëmijëve në internet

Me gjithë progresin e arritur në konsolidimin e EPRBM për identifikim, raportim dhe referim të rasteve të braktisjes dhe mosregjistrimit, në krijimin e mundësisë së raportimit në Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm të braktisjes, brenda Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim, akoma nuk është bërë fuqizimi i mekanizmave për monitorimin, mentorim dhe mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes.

Në mungesë të monitorimit sistematik të gjithë mekanizmave që lidhen me punën e EPRBM, pika më e ndjeshme vazhdon të jetë raportimi në të gjitha nivelet e arsimit:

- Raportimi në nivel vendi
- Raportimi tek mekanizmat ndërkombëtar
- Baza e të dhënave/ indikatorët/ Cilësia e të dhënave
- Raportimi bazuar në dëshmi/ Orientimi i politikave

Angazhimi i vazhdueshëm i mekanizmave të Inspektoratit të arsimit, si organ ekzekutiv qendror për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, përkatësisht zyrës qendrore në MASH dhe Sektorëve të Inspektimit të Arsimit (SIA) në Rajone, i kontribuon arritjes së rezultateve të pritshme dhe zbatimit efikas të politikave arsimore dhe politikave tjera për mbrojtjen e fëmijëve që lidhen me punën e institucioneve arsimore. Monitorimi nga IA mundëson që të kemi:

- Mekanizma koordinues funksional në nivel qendror, komunal dhe në nivel shkolle
- Sistem funksional i paralajmërimit të hershëm të braktisjes, parandalim të dhunë dhe dukurive negative
- Vetëdije e ngritur e institucioneve shkollore dhe komunale për adresimin sistemor të problemeve që e sfidojnë zhvillimin e fëmijëve.
- Rritje e cilësisë së të dhënave për fëmijët braktisës dhe ata që janë në rrezik për braktisje, rastet e dhunës...
- Rritje të regjistrimit në shkollë/ zvogëlim të braktisjes.
- Rritje të llogaridhënies, respektim të të drejtave të njeriut/fëmijëve.

Grupi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës në nivel të MASHTI, nuk kuadër të angazhimeve të tij, në vitin 2017, ka hartuar raportin përmbledhës mbi gjetjet nga monitorimi dhe mentorimi i DKA-ve dhe shkollave, lidhur me funksionimin e EPRBMSH. Raporti përmbledh anën legjislative dhe operative të

punës së MASHTI me partnerët e vet si dhe gjetjet nga procesi i monitorimit dhe mentorimit në 21 komuna të Republikës së Kosovës, mbi zbatimin e politikave kundër braktisjes së shkollimit në praktikën e përditshme të shkollave, dhe DKA-ve. Më gjerësisht shih një përmbledhje të raportit në shtojcën nr. 2 të këtij moduli të trajnimit.

Konceptet kryesore për mbrojtje të fëmijës, dhunën mosregjistrimin në shkollë dhe braktisjen e shkollimit

Në politikat arsimore që referojnë mbrojtjen e fëmijës, parandalimin e dhunës, si dhe në doracakët për ekipet shkollore dhe ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, janë dhënë disa përkufizime që lidhen me konceptet kryesore. Ato ndihmojnë shkollat, EPRBM dhe mbikëqyrësit e punës së tyre që të qartësojnë mirë specifikat dalluese të koncepteve gjatë punës në adresimin e problemeve që lidhen me parandalimin e dhunës, parandalimin e mosregjistrimit dhe braktisjen e shkollimit.

- **Fëmijë -** nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet;
- **Dhunë -** nënkupton: "Te gjitha format fizike dhe/ose emocionale të keqtrajtimit, shpërdorimit seksual, neglizhencës apo trajtimit neglizhent, shfrytëzimit komercial ose çdo lloj shfrytëzimi që ka si rezultat dëmtimin e mundshëm apo të vërtetë të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo të dinjitetit të fëmijës në kontekst të raportit të përgjegjësisë, besimit, apo forcës";
- **Mbrojtja e fëmijës** - nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës në dhe jashtë shtëpisë
- **Fëmijët e moshës shkollore** – arsimit të detyruar, por që nuk janë regjistruar dhe nuk e vijojnë shkollimin;
- **Fëmijët në rrezik për ta braktisur shkollimin** - janë fëmijë që janë regjistruar dhe po e vijojnë shkollën, por që për arsye të ndryshme, mund ta lënë shkollën pa përfunduar klasën e nëntë;
- **Fëmijët e moshës shkollore të cilët e braktisin shkollimin para kryerjes së arsimit t**ë **detyruar** /klasës së 9-të/ - janë fëmijë në moshën e arsimit të detyruar që janë regjistruar dhe e kanë vijuar shkollën, por, në një periudhë, e kanë braktisur atë;
- **Adoleshentët dhe të rinjtë të cilët e kanë kryer klasën e 9-të, por e kanë braktisur shkollimin në nivelin e arsimit të mesëm të lartë -** janë regjistruar në arsimin e mesëm të lartë, e vijojnë atë, por që për arsye të ndryshme, mund ta lënë shkollën pa përfunduar klasën e fundit të arsimit të mesëm të lartë.

> Në politikat arsimore që referojnë mbrojtjen e fëmijës, parandalimin e dhunës, si dhe në doracakët për ekipet shkollore dhe ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, janë dhënë disa përkufizime që lidhen me konceptet kryesore.

Hapi tjetër i veprimit, lidhet me njohjen dhe të kuptuarit e shkaqeve dhe arsyeve të mosregjistrimit të fëmijëve në shkollë dhe të braktisjes së shkollimit.

Faktorët që ndikojnë në mosregjistrimin dhe braktisjen e shkollimit

Ashtu si për konceptet kryesore, edhe për faktorët që ndikojnë në mosregjistrimin dhe braktisjen e shkollimit, në doracakët për ekipet shkollore dhe ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, janë listuar një varg faktorësh që ndikojnë në braktisjen e shkollimit, si:

Faktorët individualë: Sëmundjet e ndryshme, aftësitë e kufizuara, martesa e hershme, përkrahja e vogël nga familja, përfshirja në dukuri negative, përdorimi i narkotikëve, qasja individuale ndaj arsimit, etj.

Faktorët familjarë: Mungesa e kujdesit adekuat prindëror (pa të dy ose njërin prind dhe shkurorëzimet), niveli i arsimimit të prindërve, mentaliteti kulturor i familjeve, mos-bashkëpunimi/mos-adaptimi i familjes me rrethin; fëmijët si mbajtës të familjes, etj.

Faktorë shkollorë: Pozita gjeografike e shkollave (rreziqet gjatë udhëtimit sidomos në zonat malore), relacionet arsimtarë-nxënës dhe anasjelltas, nxënës-nxënës (sjelljet joadekuate, vlerësimet jokorrekte, dhuna, keqpërdorimi i teknologjisë informative, etj.), mungesa e shërbimeve adekuate profesionale në trajtimin e problemeve brenda shkollës, niveli jo i duhur i bashkëpunimit të shkollave me shërbimet e tjera komunale dhe me komunitetin, ndikimi i dukurive të jashtme negative, etj..

Faktorët socialë: Problemet sociale/varfëria, niveli jo i duhur i bashkëpunimit ndër-institucional dhe me komunitetin, dukuritë negative brenda shoqërisë, lëvizjet, migrimet, etj.

Detyra 1: Shkëmbim idesh për faktorët e mosregjistrimit të fëmijëve në shkollë dhe të braktisjes së shkollimit

Bazuar në faktorët e përshkruar më sipër dhe në përvojën tuaj dhe informacionet që ju keni për faktorët tjerë, identifikoni dhe diskutoni me kolegë faktorët që ndikojnë më shumë në mosregjistrimin e shkollës dhe faktorët që ndikojnë më shumë në braktisje të shkollimit apo në rrezik për braktisje. Arsyetoni me shembuj ilustrues adresimin e rasteve.

Faktorët që ndikojnë në mosregjistrimin e shkollës	Faktorët që ndikojnë në braktisje të shkollimit apo në rrezik për braktisje
Fëmija duhet të punojë për të mbështetur familjen	Fëmija duhet të punojë për të mbështetur familjen
Largësia e shtëpisë nga shkolla	Fëmija ka mungesat e shumta
Familja e fsheh fëmijën me nevoja të veçanta	Fëmija nuk është mirë në mësime
.....	.....

Kini kujdes!
Disa nga faktorët e mësipërm, mund të mos jenë relevantë për çdo rast të mosregjistrimit ose të braktisjes së shkollimit. Kjo do të thotë se secili rast ka historinë e vet për të cilën EPRBM duhet të mbledhin të dhëna dhe të nxjerrin përfundime për arsyet dhe masat që duhet ndërmarrë.

3.3 Kuadri ligjor për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar

Në vitet e fundit në Kosovë është rritur përqendrimi në sigurimin e cilësisë së arsimit parauniversitar, nga nevoja për një fokus më të qartë në ngritjen e rezultateve të nxënies dhe nga nevoja për përmirësim të monitorimit dhe vlerësimit të punës së institucioneve arsimore, përmes vendosjes se një mekanizmi të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në institucionet arsimore. Sistemi i sigurimit të cilësisë "përfshin të integruara të gjithë politikat, procedurat rregullat kriteret, mjetet dhe instrumentet e mekanizmat e verifikimit që të gjitha së bashku sigurojnë dhe përmirësojnë cilësinë e kërkuar nga një institucion shkollor" (EU, 2015).

Mbi bazën e dokumentit Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020, MASH ka zhvilluar dokumentet për sigurim të cilësisë (Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës, 2016), ka përcaktuar pritshmeritë themelore për çdo shkollë në Republikën e Kosovës dhe ka vendosur sistemin e vlerësimit të performancës së shkollës. Zbatimi i këtyre politikave arsimore lidhen me rolin dhe funksionet e Inspektorati i Arsimit, i cili është organ ekzekutiv qendror për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.

Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës parasheh pesë fusha të cilësisë së performancës së shkollës, respektivisht pesë shtylla të veprimtarisë së shkollës, të cilat janë referenca kryesore për vlerësimin dhe avancimin e performancës së shkollës në Kosovë. Këto pesë fusha janë: (I) Menaxhimi dhe qeverisja, (II) Kultura dhe mjedisi, (III) Mësimdhënia dhe nxënia, (IV) Zhvillimi profesional i mësimdhënësve, dhe (V) Performanca e nxënësve.

Sigurimi i cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë, ashtu si në sistemet arsimore të shumicës së shteteve të Bashkimit Evropian (BE), por edhe të shteteve të tjera, paraqet një dimension të veçantë të reformës arsimore, reformë e cila në dokumentet zyrtare ka në fokus përkrahjen e nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore të përvijuara me kurrikulën e re.

Sistemi i vlerësimit të performancës së shkollës është pjesë e politikave arsimore për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar. Vlerësimi i referohet proceseve që përdoren për të grumbulluar, analizuar dhe vlerësuar dështmitë e arritjeve individuale në mësimdhënie, praktikë profesionale të udhëheqjes së institucionit arsimor dhe arritjes së pritshmërive nga institucioni arsimor (Ligji për Inspektoratin e Arsimit, 2018). Në anën tjetër, në dokumentet e OECD-s që lidhen me vlerësimin brenda sistemit arsimor, koncepti vlerësim përfshinë në vete gjithë procesin e matjes dhe të gjykimit për dukurinë apo gjendjen për të cilën bëhet.

3.4 Funksionet e Inspektoratit të Arsimit në raport me përgjegjësitë e shkollës për mbrojtje të fëmijëve dhe parandalim të braktisjes

Njohja e kuadrit ligjor që lidhet me punën e Inspektoratit të Arsimit, është komponenti thelbësor në procesin e monitorimit të politikave arsimore. Me ligjin e ri Nr. 06/L -046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, roli i Inspektoratit të Arsimit është fuqizuar, në mënyrë të veçantë roli i tij si mekanizëm kryesor për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.

Tani, me ligjin e ri, Inspektorati i Arsimit kryen këto funksione:

- *Funksionin vlerësues* – vlerëson cilësinë e shërbimit të institucioneve arsimore;
- *Funksionin kontrollues* – kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve arsimore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- *Funksionin këshillues* – këshillon drejtuesit dhe punonjësit e institucioneve arsimore;
- *Funksionin informues/raportues* – informon ministrin, DKA-të dhe institucionet arsimore për gjetjet e inspektimit, si dhe i publikon ato në baza vjetore;
- *Funksioni mbështetës* për promovimin e praktikave të suksesshme të institucioneve arsimore dhe zhvillimin e politikave arsimore.

Ndërsa llojet e Inspektimit janë si në vijim:

- Inspektimi i përgjithshëm (Administrativ dhe Pedagogjik /VJSH/);
- Inspektimi tematik;
- Inspektimi emergjent;
- Ri-inspektimi;
- Inspektimi i cilësisë së punës dhe vlerësimi i performancës së mësimdhënësve për procesin e licencimit /VPM/.
- Inspektimi i cilësisë së punës dhe vlerësimi i performancës së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit /VPD/

Kjo tregon se IA ka mbështetje të qartë ligjore për mbikëqyrjen e zbatimit të protokollit për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar dhe platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit, përmes inspektimeve të cilësisë së punës së shkollës dhe inspektimeve tjera që realizohen nga inspektorati i arsimit

Mbikëqyrja e zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit është e lidhur ngushtë me rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e nga Inspektoratit të Arsimit. Para se të filloj procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit, nga inspektorët e arsimit kërkohet që të njohin në thelb:

- pakon e dokumenteve që lidhen me sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës, si dhe
- dokumentet themelore që rregullojnë aspektet kryesore të inspektimeve të cilësisë së punës së shkollës:
  - Standardet për praktikën profesionale për drejtorët e shkollave në Kosovë
  - Korniza strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë
  - Udhëzimet Administrative për: VPSH, VPM, VPD.

Detajet për dokumentet themelore që rregullojnë aspektet kryesore të inspektimeve të cilësisë së punës së shkollës, prezantohen dhe diskutohen në temat vijuese të modulit.

3.5 Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës – pritshmëritë e shkollës për mbrojtje të fëmijës, parandalimin e dhunës, mosregjistrimit dhe braktisjes së shkollës

Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë

Me dokumentin Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës[4], MASH ka përcaktuar pritëshmeritë themelore nga çdo shkollë që vepron në Republikën e Kosovës. Dokumenti kornizë është ndërtuar mbi ndërveprimin në mes të parimeve kryesore të Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Kosovës dhe fushave të cilësisë së performancës së shkollës. Korniza parasheh pesë fusha të cilësisë së performancës së shkollës, të cilat shërbejnë si shtylla organizative për menaxhim të shkollës, vlerësim, vetëvlerësim, planifikim dhe intervenim përmirësues. Këto pesë fusha të cilësisë janë:

a. Menaxhimi dhe qeverisja,

b. Kultura dhe mjedisi shkollor,

c. Mësimdhënia dhe nxënia,

d. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve, dhe

e. Performanca e nxënësve.

Secila fushë e cilësisë ka nga pesë kritere. Këto kritere burojnë nga pesë parimet e kurrikulës duke vënë në dukje ndikimin e secilit parim në secilën fushë të veprimtarisë së shkollës. Ndërlidhja e tyre ilustrohet në shtojcën nr.3 të këtij moduli të trajnimit.

Pritëshmeritë e Kornizës për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë për adresimin e braktisjes së shkollimit

Për të siguruar mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit, inspektorët e arsimit të përfshirë në procesin e VJPSH, fillimisht duhet ta kuptojnë qasjen ndaj vlerësimit të performancës së shkollës dhe ndikimin e saj në punën e përgjithshme të shkollës dhe kërkesat themelore që lidhen me mosregjistrimin dhe braktisjen e shkollimit. Për këtë qëllim, fillimisht duhet të analizohen me shumë kujdes:

- Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës dhe funksioni e saj në procesin e vlerësimit të jashtëm;
- Aspektet kryesore të vlerësimit (fushat cilësisë, kriteret e cilësisë[5] dhe treguesit e performancës[6]);
- Parimet dhe karakteristikat e vlerësimit të jashtëm
- Treguesit e performancës në fushën e cilësisë: **Kultura dhe mjedisi shkollor.**

4 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). Korniza e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë. IPK, Prishtinë. http://ipkmasht.rks-gov.net/kriteret-dhe-treguesit-e-cilesise-se-performances-seshkolles/

5 Kriteret e cilësisë burojnë nga parimet e kornizës kurrikulare të Arsimit Parauniversitar. Ato janë nën-ndarje të fushave të cilësisë.

6 Treguesit e performancës janë deklarata afirmative të performancës të cilët shërbejnë si reference për vlerësimin e performancës se shkollës.

Pritëshmeritë e shkollës për mbrojtje të fëmijës, parandalimin e dhunës, mosregjistrimit dhe braktisjes së shkollës, të përcaktuara në kuadër të fushës së cilësisë **Kultura dhe mjedisi shkollor,** prezantohen në kuadër të temës së këtij moduli: **Vlerësimi i jashtëm të shkollës në fushën e cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor**

Për të bërë përgatitjet e duhura dhe për të siguruar proces cilësor të mbikëqyrjes së zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit përmes procesit të VJPSH, bazuar në mundësitë dhe kërkesat e Kornizës, Inspektorati i Arsimit duhet të sigurojë që fillimisht të gjithë Inspektorët e Arsimit:

- t'i kenë të qarta funksionet dhe detyrat e caktuara me Ligjin për Inspektoratin e Arsimit, si dhe delegimi e përgjegjësive brenda Inspektoratit të Arsimit;
- t'i kenë të qarta pritëshmeritë e reja për shkollën;
- të jenë të njoftuar me platformën për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit;
- të jenë të njoftuar me rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e EPRBM, si dhe me masat që janë ndërmarrë për zbatimin e platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit;
- të njihen dhe të kenë të kuptuar të përbashkët për konceptet kryesore dhe faktorët e rrezikut për mosregjistrimin, mosvijim dhe braktisje të shkollimit.

3.6 Vlerësimi i performancës së shkollës

I referohet

- Vlerësimit të brendshëm i shkollës / vetëvlerësimit të shkollës
- Planifikimit zhvillimor i shkollës
- Plani vjetor i veprimit – planit të përmirësimit
- Vlerësimit të jashtëm i shkollës
- Periudhës së zbatimit të vetëvlerësimit, vlerësimit të jashtëm dhe planifikimit zhvillimor të shkollës

Parimet kryesore të kryesore të vlerësimit të performancës së shkollës

- Pjesëmarrja
- Transparenca
- Objektiviteti
- Saktësia

Vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollës në Kosovë është pjesë e sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës. Referuar udhëzuesit për vlerësim të jashtëm të performancës së shkollës (Udhëzuesi për VJPSH, IPK, 2017), duhet të jetë vlerësim:

- i fokusuar në rezultate të performancës së shkollës, arritjet e nxënësve;
- i bazuar në dëshmi të verifikuara;
- i ndjeshëm ndaj veçorive të shkollës;
- i pasqyrimit të gjendjes dhe trendit të performancës së shkollës;
- në funksion të planifikimit zhvillimor të shkollës; dhe
- në funksion të sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar

Karakteri zhvillimor i sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës, si dhe cilësia e arsimit, e reflektuar mjaft kritike në raportet e studimit PISA (Raportet PISA 2015 dhe 2018), kërkojnë që vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollës të përmbushë rolin që ka, të ushtroj kontroll të planifikuar, sistematik dhe të garantojë që institucionet arsimore në Kosovë punojnë sipas standardeve të cilësisë të përcaktuara nga MASH.

Fusha e cilësisë *Performanca se nxënësve* është dimensioni thelbësor për vlerësimin e performancës së shkollës pasi që pasqyron efektivitetin e shkollës në realizimin e misionit thelbësor të saj (IPK, 2017).



Vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollës shërben si metavlerësim për procesin e vetëvlerësimit të shkollës, me qëllim (a) analizën e kapacitetit të shkollës për vetëvlerësim, (b) shfrytëzimin e gjetjeve të vetëvlerësimit për planifikim të përmirësimit/avancimit të cilësisë dhe (c) identifikimin e pikave të dobëta, respektivisht nevojave për përkrahjen e shkollave në procesin e vetëvlerësimit dhe planifikimit zhvillimor (Mehmeti, S. Boshtrakaj, L., Bytyqi, L. Zylfiu, H. & Potera, I., 2018).

Në udhëzuesin për vlerësim të jashtëm të performancës së shkollës (IPK, 2017) janë përshkruar në detaje tre hapat kryesorë për realizimin e VJPSH:

- Përgatitja për vlerësim të jashtëm
- Procesi i vlerësimit
- Përgatitja dhe shpërndarja e raportit të vlerësimit

VJPSH është një përvojë fillestare në kuadër të sistemit për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë. Secili proces, sidomos proceset e ndjeshme dhe të reja, që fillojnë për herë të parë patjetër që duhet pasur parasysh kultura e vlerësimit brenda sistemit arsimor, (OECD, 2013). Për më tepër, tendenca në arsimin parauniversitar të Kosovës drejt autonomisë së shkollës, fillimi i zbatimit të vetëvlerësimit të shkollës, delegimi i përgjegjësive të veçanta te mekanizmat e brendshëm të shkollës , siç janë EPRBM, rrit nevojën për të monitoruar se si po punojnë shkollat, për të vlerësuar cilësinë e procesit të vetëvlerësimit dhe përdorimit të rezultateve të tij për vendimmarrje në nivel shkolle, cilësinë e zbatimit të reformës kurrikulare, funksionimin e EPRBM dhe mekanizmave për sigurimin e cilësisë në nivel shkolle.

Prandaj,

për procese të ndjeshme dhe të reja të mbikëqyrjes së punës në shkollë, siç është procesi i VJPSH, nevojitet njohje e mirë e sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës, parimeve, funksioneve dhe qëllimeve të tij, si dhe nevojitet reflektim i brendshëm për përvojat fillestare, për mësimet, sfidat dhe problemet që duhet adresuar për të përmirësuar cilësisë e procesit të VJPSH.

Po ashtu,

për procese të tilla duhet të merren në konsideratë kultura e institucioneve arsimore në proceset e vlerësimit, përgatitjet dhe kapacitetet e inspektoratit, në mënyrë që ato t'i përgjigjen hapave kryesorë që duhet ndërmarrë për realizimin e VJPSH në të gjitha institucionet arsimore, siç përshihet me kornizën ligjore për vlerësimin e performancës së shkollës.

3.7 Vlerësimi i performancës së shkollës në fushën e cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor

Siç është përshkruar në pakon e dokumenteve për vlerësim të performancës së shkollës dhe në udhëzuesit përkatës, vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollës, ashtu si vlerësimi i brendshëm, realizohet në tre nivele:

- Në nivel të kritereve
- Në nivel të fushave të cilësisë dhe
- Në nivel të përgjithshëm

Pra, objekt i vlerësimit janë të gjitha fushat e cilësisë – pesë fushat e cilësisë, si dhe të gjithë kriteret e cilësisë – 25 kriteret e cilësisë. Varësisht nga qëllimet e vlerësimit, vlerësimet paraprake, fushat e cilësisë të vlerësuara nga shkolla, kërkesat dhe nevojat për vlerësime të veçanta, inspektorati i arsimit mund të përcaktoj edhe fushat/en e vlerësimit dhe kriteret e cilësisë në të cilat ka për qëllim ta fokusoj procesin e VJPSH në një institucion arsimor të caktuar.

Prandaj,

kjo pjesë e këtij moduli të trajnimit për Inspektorët e Arsimit do të fokusohet në fushën e cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor, në mënyrë më specifike në kriterin e cilësisë dhe treguesit e performancës që lidhen me EPRBM dhe nivelin e braktisjes së shkollimit, pasi që ky modul është i fokusuar në këtë tematikë.

Në fushën e cilësisë: *Kultura dhe mjedisi shkollor*, në dy kritere të cilësisë, përkatësisht në pesë tregues të performancës së shkollës në kuadër të këtyre dy kritereve të cilësisë, në mënyrë të drejtpërdrejtë adresohen aspektet që lidhen me parandalimin e dhunës në shkollë:

2.1.3. Nxënësit janë të mbrojtur nga lëndimet dhe dhuna/presioni emocional.

2.5.1. Shkolla ka mekanizma efektiv për t'u marrë me rastet e dhunës në shkollë dhe rastet e aksidenteve dhe fatkeqësive elementare.

2.5.3. Shkolla ka standarde të sjelljes, kujdesit dhe mirëqenies, të hartuara në bashkëpunim me organet shkollore, me prindër dhe komunitet.

2.5.4. Gjithë personeli i shkollës është në dijeni për të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara me standardet e sjelljes, kujdesit dhe mirëqenies.

2.5.5. Pakoja e rregulloreve të shkollës është në funksion të parandalimit të abuzimeve, ekseseve dhe shkeljeve të të gjitha llojeve.

Ndërsa në kriterin e cilësisë 2.2. të kësaj fushe: **Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërim e kompetencave**, janë përcaktuar tre (3) tregues të performancës, të cilët shërbejnë si pika referuese bazë për të mbikëqyrë zbatimin e platformës për PRBM. Këta tregues të performancës janë si në vijim:

2.2.2 Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj mosregjistrimit dhe braktisjes (EPMRB) është funksional dhe ka procedura të qarta për identifikimin e barrierave të cilat mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.

2.2.3 Shkolla ka krijuar rrjete të bashkëpunimit me ofrues të jashtëm të shërbimeve sociale, shëndetësore e ekonomike për eliminimin e barrierave, të cilat mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.

2.2.6 Niveli i braktisjes së shkollës nga nxënësit është shumë i ulët.

Në vijim është dhënë një përshkrim i shkurtër i disa treguesve të performancës së shkollës (kriteri i cilësisë 2.2.) dhe pritshmëritë nga Inspektorati i Arsimit për mbledhjen e të dhënave të nevojshme gjatë VJPSH për të përshkruar gjendjen dhe trendin e shkollës në përmbushjen e këtyre treguesve.

Treguesit e performancës	Përshkrimi i treguesve të performancës	Disa burime të mundshme
2.2.2 Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj mosregjistrimit dhe braktisjes (EPMRB) është funksional dhe ka procedura të qarta për identifikimin e barrierave të cilat mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.	Shkolla duhet të angazhohet për identifikimin e faktorëve të cilët mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë. Për këtë shkolla duhet të ofroj dëshmi që lidhen me punën e EPRBM, përfshirë instrumentet për identifikim dhe regjistrim të fëmijëve në rrezik të braktisjes dhe fëmijëve jashtë shkolle në zonën e mbulimit, identifikimin, regjistrimin dhe menaxhimin e rasteve, etj.	▶ Procesverbalet e takimeve, planet e punës, vendimet..; ▶ Procedurat e shkollës për identifikimin e barrierave të cilat pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë. ▶ Instrumentet për identifikim dhe regjistrim të fëmijëve në rrezik të braktisjes dhe fëmijëve jashtë shkolle në zonën e mbulimit, identifikimin, regjistrimin dhe menaxhimin e rasteve; ▶ Raportet e barrierave të identifikuara dhe masat e planifikuara dhe realizuara për eliminimin e tyre.
2.2.3 Shkolla ka krijuar rrjete të bashkëpunimit me ofrues të jashtëm të shërbimeve sociale, shëndetësore e ekonomike për eliminimin e barrierave, të cilat mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.	Përmes punës me nxënës, me prindërit dhe me ofruesit tjerë të shërbimeve (jashtë shkolle) shkolla duhet t'i adresoj faktorët të cilët pengojnë qasjen vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë. Për këtë shkolla duhet të ofrojë dëshmi të lidhura me bashkëpunimin me komunitetin jashtë shkollës, si dhe rezultate të prekshme të cilat kanë mundësuar që evitohen pengesat që lidhen me qasjen në mësim, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.	▶ Evidencat mbi praktikat e bashkëpunimit me ofrues tjerë të shërbimeve (Qendra për punë sociale, Qendra të mjekësisë familjare, OJQ, biznese etj.). ▶ Masat e aplikuara me ofrues tjerë të shërbimeve lidhur me eliminimin e barrierave të cilat mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë, si dhe evidencat për efektivitetin e tyre (p.sh. pajisja më llaptop e nxënësve gjatë mësimit online - kohës së pandemisë Covid 19).
2.2.6 Niveli i braktisjes së shkollës nga nxënësit është shumë i ulët.	Shkolla duhet të udhëhiqet nga parimi se secili fëmijë duhet ta përfundojë arsimin e detyruar, apo edhe arsimin e mesëm të lartë të regjistruar. Për këtë shkolla duhet të menaxhoj me kujdes të gjitha rastet të cilat janë në rrezik për braktisje të shkollimit, të siguroj mjedis mundësues për të gjithë fëmijët që të përfundojnë me sukses shkollimin, të sigurojë mësimdhënie cilësore....	▶ Raportet për trendin e braktisjes së shkollimit në vitet e fundit. ▶ Raportet për vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në vitet e fundit. ▶ Masat e aplikuara për eliminimin e barrierave dhe evidencat për efektivitetin e tyre. ▶ Masat e aplikuara për menaxhimin e rasteve të braktisjes, menaxhimin e mungesave...

Kini kujdes!
Faktorët shkollorë që ndikojnë në braktisjen e shkollimit janë të shumtë, prandaj Inspektorët e Arsimit gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të platformës për Parandalim dhe Reagim ndaj Mosregjistrimit dhe Braktisjes, duhet të kenë në konsideratë edhe pritëshmeritë tjera për shkollën, të cilat janë përcaktuar me dokumentin Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës.

Detyra 2: Shkëmbim idesh për adresimin e mosregjistrimit të fëmijëve në shkollë dhe të braktisjes së shkollimit në raportet e VJPSH, me theks të veçantë në pjesën për Fushën e cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor

Analizoni disa pjesë të raporteve **në shtojcën 7 të këtij moduli**, përshkruani se si është adresuar në ato pjesë të raporteve aspekti i mosregjistrimit dhe braktisjes së shkollës, si dhe nxirrni dy-tri përfundime çfarë duhet bërë në të ardhmen për adresim të drejtë dhe të plotë të problemeve që identifikohen në këtë fushë.

3.8 Instrumentet për mbledhjen e të dhënave

Në udhëzuesin për vlerësim të jashtëm të performancës së shkollës (IPK, 2017) janë përshkruar në detaje udhëzimet për identifikimin e burimeve dhe instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, si dhe udhëzimet për përgatitja e instrumenteve dhe mbledhjen e të dhënave për VJPSH.

Sipas udhëzimeve të dhëna në udhëzuesin për VJPSH, përzgjedhja e teknikave të cilat do të aplikohen dhe përpilimi i instrumenteve përkatëse bëhet në bazë të treguesve të performancës të përcaktuar për secilin kriter të cilësisë, në kuadër të fushave të cilësisë, që janë në fokus të vlerësimit të jashtëm. Për të lehtësuar punën e Ekipit të Vlerësimit të Jashtëm, në shtojcën e udhëzuesit është dhënë lista e treguesve me pyetje orientuese dhe mjetet e verifikimit (burimet) të të dhënave në kuadër të secilit kriter (shih faqen vijuese).

Gjithashtu, në udhëzuesin për VJPSH janë vendosur mostra të instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, përfshirë lista kontrolluese, protokoll të intervistës, pyetësorë për anketa, protokoll vëzhgimi, si dhe udhëzime e protokoll për takimet me fokus grupe. Për shkak se procesi i mbledhjes së të dhënave lidhet me specifikat e kontekstit të shkollave dhe burimeve që mund të sigurohen nga dokumentimi i punës së shkollës, Ekipet e Vlerësimit të Jashtëm janë sugjeruar që mbi bazën e udhëzimeve të dhëna në udhëzues të përgatisin instrumente për mbledhjen e të dhënave për VJPSH.

Ndërsa, formulari i vlerësimit të performancës së shkollës është i përbashkët si për vlerësimin e brendshëm të shkollës, ashtu edhe për VJPSH, pasi konstatimi i gjendjes për tregues të performancës, vlerësimi i kritereve të cilësisë, vlerësimi i fushave të cilësisë dhe vlerësimi i përgjithshëm i performancës së shkollës, është vlerësim cilësor i bazuar në evidenca dhe dëshmi në raport me treguesit e performancës dhe me nivelet e cilësisë së performancës.

Prandaj,

mbi këtë bazë dhe këtë orientim duhet të vazhdohet dhe procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të platformës për Parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit, në kuadër të VJPSH.

Në dritën e kërkesave për mbikëqyrjen e platformës për Parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit, në kuadër të VJPSH, nevojitën instrumente të veçanta, të cilat sigurojnë dëshmi të mjaftueshme për nivelin e zbatimit, sfidat, nevojat dhe mundësitë për ta përmirësuar dhe avancuar këtë platformë. Si orientim për këtë mund të jenë të dhënat orientimet e dhëna në udhëzuesin për VJPSH lidhur me pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues, si dhe orientimet për burimet e mundshme për mbledhjen e të dhënave.

Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave		
Treguesit e performancës së shkollës	**Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues**	**Disa burime të mundshme të të dhënave**
2.2.1 Niveli i pritshmërisë së shkollës për zotërimin e kompetencave, për arritjet akademike dhe për realizimin individual të secilit nxënës është i lartë. *2.2.2 Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj mosregjistrimit dhe braktisjes (EPMRB) është funksional dhe ka procedura të qarta për identifikimin e barrierave të cilat mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.* *2.2.3 Shkolla ka krijuar rrjete të bashkëpunimit me ofrues të jashtëm të shërbimeve sociale, shëndetësore e ekonomike për eliminimin e barrierave, të cilat mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.* *2.2.4 Shkolla mundëson realizimin e potencialit të secilit nxënës përmes aktiviteteve të ndryshme jashtëkurrikulare që kanë për qëllim avancimin e prirjeve individuale të nxënësve.* *2.2.5 Mësimdhënësit përpilojnë dhe zbatojnë PIA-në për nxënësit me nevoja të veçanta në arsim.* *2.2.6. Niveli i braktisjes së shkollës nga nxënësit është shumë i ulët.*	2.1.1 Si e vlerëson shkolla kapacitetin e nxënësve dhe kapacitetin e shkollës për të përkrahur të gjithë nxënësit në zotërimin e kompetencave dhe realizimin individual të secilit nxënës? Cili është qëndrimi i organeve udhëheqëse të shkollës? Po i mësim-dhënësve? 2.1.2 A i kushton shkolla vëmendje identifikimit të faktorëve që ndikojnë në procesin e të nxënit dhe zhvillimin e kompetencave kryesore? Cilët janë faktorët kryesorë që pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë? A janë evidentuar ata nga shkolla? 2.1.3 Cilat janë praktikat e bashkëpunimit me ofruesit tjerë të shërbimeve për fuqizim të fëmijëve dhe familjeve të tyre? Cilat forma të përkrahjes aplikohen në shkollë për të siguruar mundësi të barabarta për zhvillim të kompetencave kryesore? 2.1.4 Cilat forma të përkrahjes aplikohen për avancimin e prirjeve të nxënësve në fusha të ndryshme me qëllim të realizimit të plotë të potencialit të tyre? Sa është interesimi i nxënësve për pjesëmarrje në këto aktivitete? Cili është mendimi i nxënësve për to? 2.1.5 A është efektive qasja e shkollës për përkrahjen e nxënësve me nevoja të veçanta duke përfshirë integrimin e tyre në jetën sociale të shkollës? Çfarë masash aplikon shkolla? A janë ato efektive? 2.1.6 Cili është niveli dhe trendët e braktisjes së shkollës? Çfarë masash aplikon shkolla për të parandaluar braktisjen?	▶ Procedurat e shkollës për identifikimin e barrierave të cilat pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë. ▶ Raportet e barrierave të identifikuara dhe masat e planifikuara për eliminimin e tyre. ▶ Evidencat mbi praktikat e bashkëpunimit me ofrues tjerë të shërbimeve (Qendra për punë sociale, Qendra të mjekësisë familjare, OJQ, biznese etj.). ▶ Masat e aplikuara për eliminimin e barrierave dhe evidencat për efektivitetin e tyre. ▶ Programi i mësimit plotësues, shtues dhe jashtë-kurrikular që aplikohet në shkollë dhe evidencat e realizimit.

Instrumentet që i përdor Inspektorati i Arsimit gjatë mbledhjes së të dhënave për VJPSH, pra edhe të dhënat për punën e shkollës për identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve në rrezik të braktisjes dhe fëmijëve jashtë shkolle, mund të jenë të ndryshme, përfshirë analiza e dokumenteve – listë kontrolli, protokoll vëzhgimi i orëve mësimore, intervista, pyetësorë, etj.

Për të racionalizuar dhe ekonomizuar mundin kohën e IA për VJPSH, por edhe për inspektime të tjera, sugjerohet që të fillohet me dokumentimin e punës së shkollës për aspektet që janë objekt i monitorimit dhe vlerësimit. Prandaj, në shtojcën **nr.4 është dhënë një shembull i një liste kontrolluese** për Inspektorët e arsimit, e përshtatur për nevojat e tyre, bazuar në pakon e instrumenteve për identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve në rrezik të braktisjes dhe fëmijëve jashtë shkolle, të vendosura në doracakun për EPRBM-të shkollore, si dhe **shtojca 5 Formulari me listën e pyetjeve sipas indikatorëve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes.**

Pra, krahas përdorimit të listës së kontrollit, analizës së dokumentimit etj., për qëllime të mbikëqyrjes së zbatimit të platformës dhe punës së EPRBM, inspektorët e arsimit sugjerohen që të përgatisin dhe përdorin instrumente/formular me pyetje dhe kërkesa të tjera që i mundësojnë

marrjen e të dhënave të plota dhe të besueshme lidhur me indikatorët relevantë për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes.

Është e rëndësishme që fushat e trajtimit dhe pyetjet për mbledhjen e të dhënave përmes instrumenteve të caktuara, të mbulojnë:

- Praktikat e funksionimit të EPRBM;
- Adresimin e braktisjes dhe mosregjistrimit përmes planeve të veprimit dhe masave të ndërmarra;
- Qasjet në identifikimin e fëmijëve/nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës dhe të shkaqeve kryesore që ndikojnë në braktisje të shkollës;
- Përvojat e shkollave në eliminimin e barrierave, të cilat pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë;
- Praktikat e regjistrimit në sistemin e paraljamerimit të hershëm dhe të mbikëqyrjes së rasteve të nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës;
- Monitorimin e kalimit në shkollë;
- Raportimi i rasteve të fëmijëve/nxënësve të cilët kanë braktisur shkollën;

3.9 Adresimi i gjetjeve kryesore që lidhen me mbrojtjen e fëmijës në raportet e VJPSH

Gjëja e parë e rekomanduar në drejtim të adresimit të gjetjeve kryesore që lidhen me mbrojtjen e fëmijës në raportet e VJPSH është mbështetja në evidenca dhe burime të sigurta e konstatimeve dhe vlerësimeve lidhur me mbrojtjen e fëmijës nga institucionet shkollore, përkatësisht masat për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit.

Në udhëzuesin për vlerësim të jashtëm të performancës së shkollës (IPK, 2017) janë dhënë udhëzime dhe orientime edhe për raportin e VJPSH, i cili përgatitet nga Ekipi i vlerësimit të jashtëm, në bazë të gjetjeve të evidentuara në Formularin për VJPSh. Gjithashtu, në udhëzues është dhënë struktura e raportit përmbledhës, sipas secilës raporti përmbledhës organizohen si në vijim:

- Përmbledhje e procesit të vlerësimit të jashtëm të shkollës
- Pjesa 1: Të dhëna të përgjithshme për shkollën
- Pjesa 2: Gjetjet kryesore për performancën e përgjithshme dhe sipas fushave të cilësisë së shkollës
- Pjesa 4: Gjetjet- performanca në nivel të fushave të cilësisë
- Pjesa 5: Anët e forta, sfidat dhe trendi
- Pjesa 6: Rekomandimet dhe afatet për zbatimin e tyre; dhe Shtojcat

Udhëzimet tjera lidhur me raportin e VJPSH i referohen diskutimit të draft raportit me shkollën me qëllim që të arrihen konkluzione rreth tij dhe një konsensus i përbashkët në lidhje me plotësimet/ndryshimet eventuale në Raportin e vlerësimit të jashtëm të shkollës, finalizimit dhe dorëzimit të raportit.

Në analizën krahasuese të raporteve të VJPSH, të 12 raporteve përmbledhëse të shkollave që janë përfshirë në procesin e vlerësimit të jashtëm, ose 20% nga gjithsej 59 raporte të vlerësimit të jashtëm, të realizuar në kuadër të studimit *Vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollës si mekanizëm për sigurimin e cilësisë, gjendja dhe perspektiva* (Kërkime pedagogjike, IPK 2020), janë evidentuar disa gjetje të cilat mund analizohen me qëllim të përmirësimit të cilësisë së raporteve nga procesi i VJPSH.

Në përgjithësi,

vërehet se në raportet e VJPSH ka dallime në mënyrën e përgatitjes së tyre, ka pak të dhëna, evidenca dhe konstatime të gjetjeve kryesore që lidhen me zbatimin e platformës për PRBM

Dallimet janë të dukshme në strukturën e organizimit të gjetjeve kryesore, përmbajtjen e përshkrimit të gjetjeve kryesore, ndërlidhjen e gjetjeve kryesore me kriteret e cilësisë, treguesit e performancës së shkollës sipas kritereve të cilësisë dhe me të dhënat e përgjithshme për shkollën. Gjithashtu, dallimet janë të dukshme edhe në mënyrën e përcaktimit dhe përshkrimit të rekomandimeve për shkollën, numrin e rekomandimeve dhe afatet e zbatimit të tyre.

Prandaj,

me qëllim që IA të përgatisë raporte cilësore nga procesi i VJPSH-së, nevojitet një mekanizëm i brendshëm i IA që merr përgjegjësi për të redaktuar në aspektin profesional dhe teknik raportet e VJPSH-së dhe të nxjerrë raporte të përgjithshme në shkallë vendi për cilësinë e punës së shkollave dhe masat e ndërhyrjet e nevojshme në sistem, siç p.sh. mund të jenë masat për adresimin e mosregjistrimit dhe braktisjes së shkollimit

Një përmbledhje e gjetjeve kryesore nga studimi dhe disa konstatime nga raportet e VJPSH të analizuara, që lidhen me punën e EPRBM dhe adresimin e braktisjes, është dhënë në **shtojcën nr.6 të këtij moduli.** Analizoni në mënyrë kritike, me qëllim përmirësimin dhe avancimin e cilësisë së raporteve të VJPSH.

3.10 Mbikëqyrja e zbatimit të politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve, përmes inspektimeve të cilësisë së punës së shkollës dhe inspektimeve tjera nga IA

Për ta institucionalizuar procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit, Inspektorati i Arsimit duhet të zhvillojë një set të përgatitjeve për ta integruar këtë proces të mbikëqyrjes në kuadër të inspektimeve të cilësisë së punës së shkollës dhe inspektimeve tjera që realizohen nga inspektorati i arsimit. Kjo duhet të bëhet për shkak të shumësisë së detyrave dhe përgjegjësive që ka me Inspektorati i Arsimit me legjislacionin e ri dhe për shkak të numrit të kufizuar të inspektorëve të arsimit, në raport me numrin e institucioneve arsimore parauniversitare që duhet ti mbikëqyrin.

Disa nga përgatitjet që konsiderohen më të nevojshme për ti bërë Inspektorati i Arsimit, për ta realizuar me kompetencë mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit janë:

- Informimi i brendshëm lidhur me përgjegjësitë që ka IA në mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit
- Analiza e kontekstit të përgjithshëm të punës së Inspektoratit të Arsimit
- Hartimi i një plani gjithëpërfshirës lidhur me VJPSH, inspektimet e cilësisë së punës së shkollës dhe inspektimeve tjera, i cili siguron mbulueshmëri më të gjerë të institucioneve arsimore, në baza vjetore
- Shqyrtimi dhe përdorimi i raporteve nga moduli i Sistemit për Paralajmërim të Hershëm (SPH) në SMIA
- Realizimi i planit të punës së Inspektoratit të arsimit
- Raportimi i brendshëm dhe mekanizmat përkatës që lidhen me përgjegjësi në fusha të caktuara, për të cilat IA ka gjetje që duhet të raportohen dhe ka përgatitur masa që duhet të ndërmerren me qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit parauniversitar në Kosovë (p.sh. Divizioni për kurrikula, EPRBM në nivel qendror, etj.)

Standardet për praktikën profesionale për drejtorët e shkollave në Kosovë

Dokumenti për Standardet për praktikën profesionale për drejtorët e shkollave në Kosovë[7] përcakton gjashtë (6) standarde, të cilat përveç tjerash janë pika referimi për sistemin e zhvillimit profesional të drejtorëve të shkollave dhe për instrumentet e vlerësimit të performancës së menaxherëve të shkollave në Kosovë.

Standardet për praktikën profesionale për drejtorët e shkollave në Kosovë përbehen nga treguesit e njohurive dhe treguesit e performancës. Në përshkrimet e katër standardeve ka aspekte që pasqyrojnë treguesit e njohurive dhe të performancës në ndërlidhje me rolin e drejtorëve të shkollave në EPRBSH:

- **Standardi 2** (Cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies): Drejtori i shkollës siguron që të gjithë nxënësit të kenë qasje të vazhdueshme në mundësitë e mësimdhënies dhe mësimnxënies cilësore duke nxitur një kulturë të shkollës që vlerëson dhe mbështet të mësuarit e nxënësve, zhvillimin e stafit profesional sipas mundësive të barabarta;
- **Standardi 3** (Planifikimi dhe Menaxhimi): Drejtori i shkollës menaxhon shkollën, aktivitetet shkollore dhe burimet për të siguruar përjetimin e një mjedisi të sigurt, të shëndetshëm dhe efektiv të të mësuarit;
- **Standardi 4** (Bashkëpunimi dhe ndërveprimi/ bashkërendimi): Drejtori i shkollës ndërton marrëdhënie të forta me komunitetin e shkollës (nxënës, mësimdhënës, prindër, bordi i shkollës dhe akterë të tjerë) si dhe promovon udhëheqjen e përbashkët në përputhje me interesat e nxënësve;
- **Standardi 5** (Legjislacioni dhe Shoqëria):Drejtori i shkollës kupton dhe përgjigjet në mënyrë etike ndaj konteksteve politike, sociale, ekonomike, ligjore dhe kulturore që ndikojnë në shkollë;

7 https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/udhezim-administrativ-04-2012-shqip.pdf

Bazuar në këtë dokument, MASH ka zhvilluar sistemin e vlerësimit të performancës së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave, si dhe instrumentet për vlerësim të brendshëm dhe vlerësim të jashtëm të performancës së drejtorëve[8] dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave. Inspektorati i Arsimit është përgjegjës për vlerësimin e jashtëm.

Mbi këtë bazë:

Vlerësimi i performancës së drejtorëve përfshin kompetencat e drejtorit në udhëheqje të shkollës, pra edhe kompetencat e tij për udhëheqje dhe mbështetje të EPRBM, kur kemi parasysh se sipas nenit 5 të UA për EPRBM, drejtori i shkollës është pjesë e këtij ekipi.

Korniza strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë

Korniza strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve[9], përcakton standardet e profesionit të mësimdhënësit, të cilat janë referenca kryesore për përgatitje të mësimdhënësve, përkrahje dhe zhvillimin profesional, vlerësim të performancës dhe për promovim të mësimdhënësve në karrierë. Dy (2) nga shtatë (7) standardet e profesionit të mësimdhënësit, kanë ndërlidhje me qëndrimet, sjelljet dhe angazhimin e mësimdhënësve për sigurimin e mirëqenies së nxënësve dhe partneritetin me kolegë, prindër dhe komunitetin, aspekte këto që ofrojnë mundësi për të vlerësuar performancën e mësimdhënësve në raport me angazhimin e tyre për parandalimin dhe reagimin kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë:

Standardi nr. 2: Mësimdhënësi demonstron qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive për mirëqenien e nxënësve dhe mësimit; dhe

Standardi nr. 7: Mësimdhënësi angazhohet profesionalisht me kolegë, prindër dhe komunitet/bashkësi.

Mbi këtë bazë:

Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve (VPM) përfshin edhe kompetencat e mësimdhënësit që lidhen me standardet 2 dhe 5.

Kujdes!
Jo çdo mësimdhënës mund të jetë anëtarë i EPRBM, mirëpo çdo mësimdhënës duhet ti kontribuojë mirëqenies së nxënësve, barazisë, pjesëmarrjes dhe gjithëpërfshirjes, mos diskriminimit, zhvillimit të kompetencave, etj., aspekte këto që lidhen me parimet e kurrikulës dhe me parimet e funksionimit të EPRBM.

Mbi këtë bazë:

Gjatë një procesi të vlerësimit (p.sh. VPM, VPD)), mund të sigurohen informata bazike, të cilat plotësohen me të dhëna shtesë, shqyrtohen, analizohen në procese të tjera të vlerësimit, siç është VJPSH, apo shërbejnë si pikënisje për ti vërtetuar përmes inspektimeve tematike.

Është me rëndësi të veçantë që:

Vlerësimet që realizohen nga Inspektorati i Arsimit, të shfrytëzohen për perspektiva të shumta, përtej "kutisë" temës së inspektimit, drejt identifikimit të nevojave për të trajtuar më thellësisht tema të caktuara që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve/nxënësve dhe të interesit të tyre, bazuar në kërkesat e shoqërisë. Duke pasur në konsideratë qëllimin e vlerësimit dhe përmbushjen e atij qëllimi në mënyrë efektive.

8 https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/10/20201013131849347-rotated-1.pdf

9 https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/04/kornize-strategjike.pdf

3.11 Raportet përmbledhëse vjetore të Inspektoratit të Arsimit

Një nga detyrat e rëndësisë së veçantë në punën e Inspektoratit të Arsimit, është përgatitja e raporteve përmbledhëse vjetore të Inspektoratit të Arsimit, si një mekanizëm për informim, transparencë, por edhe për llogaridhënie.

Një nga detyrat e para në drejtim të konsolidimit të përvojës dhe praktikës për përgatitje të raporteve përmbledhëse vjetore të IA lidhur me monitorimet dhe inspektimet e kryera, vlerësimet e cilësisë së punës në shkollë, etj., është përcaktimi i një formati dhe strukture të raportimeve që mundësojnë raporte përmbajtjesore dhe që racionalizojnë kohen për të përgatitur raporte përmbledhëse në fushat e caktuara.

Raportet përmbledhëse duhet të tregojnë për:

- kontekstin e fushave që mbulojnë raportet (p.sh. VJPSH, VDSH, VPM);
- metodologjinë e punës dhe procesin e realizimit të monitorimeve, inspektimeve, vlerësimeve, etj.;
- zhvillimet dhe arritjet në fushat që mbulon raporti, konstatimet për gjendjen në fushat e caktuara;
- sfidat dhe problemet e identifikuara, por edhe mësimet gjatë proceseve të vlerësimeve, monitorimeve dhe inspektimeve;
- informimi dhe raportimi i rregullt tek mekanizmat përkatës;
- Masat për përmirësim dhe avancim në fushat përkatëse;
- Planifikimet orientuese për vitin vijues

Çka duhet të përmbajnë raportet përmbledhëse vjetore lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të protokollit për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar dhe platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit ?

Në parim edhe raportet përmbledhëse vjetore lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të protokollit për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar dhe platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit, duhet të kenë një format dhe strukturë të vendosur nga Inspektorati i Arsimit.

Aspektet që mund të mbulojë raporti përmbledhës vjetor në këtë fushë, mund të jenë të njëjta apo të përafërta me ato që u përshkruan me lartë, mirëpo përmbajtja duhet të mbulojë të gjitha aspektet që lidhen me zbatimin e platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit, për të cilat janë mbledhur të dhëna, përfshirë:

- Praktikat e funksionimit të EPRBM dhe mekanizmave tjerë për mbrojtjen e fëmijës;
- Qasjet në identifikimin e fëmijëve/nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës dhe të shkaqeve kryesore që ndikojnë në braktisje të shkollës;
- Përvojat e shkollave në menaxhimin e rasteve në rrezik të braktisjes, eliminimin e barrierave, të cilat pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë;
- Praktikat e regjistrimit në sistemin e paralajmërimit të hershëm, mbikëqyrjes së rasteve të nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës dhe raportimit tek mekanizmat tjerë;
- Masat për eliminimin e barrierave, të cilat pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë;
- Nevojat për ngritjen e kapaciteteve të mekanizmave shkollor për mbrojtjen e fëmijëve;

Si të raportohen gjetjet tek institucionet arsimore dhe për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) të braktisjes në SMIA?

Përvoja ka treguar se shumë shpesh institucionet arsimore, përfshirë edhe Inspektoratin e Arsimit, kanë bërë punë të madhe në përmbushjen e rolit të tyre, në gjetjen e të dhënave të rëndësishme, në gjetjen e përvojave të mira, por edhe në identifikimin e problemeve të shumta, por ato kanë mbetur brenda njësisë ose sektorit, nuk janë ndarë me sektorët tjerë dhe nuk janë bërë transparente për komunitetin e gjerë arsimor.

Zhvillimet dhe arritjet, konstatimet për gjendjen në fushat e caktuara, sfidat dhe problemet e identifikuara, në raport me zbatimin e platformës dhe masave për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit, duhet të raportohen tek mekanizmat përkatës. Për ta realizuar këtë, IA duhet të përgatisë një plan orientues për informimin e mekanizmave përkatës lidhur me zbatimin e platformës për PRBM.

Plani i informimit duhet të përfshijë së paku kohën dhe mënyrën e informimit, çështjet themelore për të cilat duhet të informohen mekanizmat përkatës, përgjegjësit për informim komunikim dhe raportim tek mekanizmat përkatës, etj.

Është e rëndësishme që të diskutohet brenda inspektoratit një plan i tillë i informimit dhe te vendoset si një mjet punë për mbikëqyrje efikase të zbatimit të platformës për PRBM.

4

Shtojca

Shtojca 1:

Roli i institucioneve arsimore në adresimin e punës së fëmijëve- Përmbledhje e raportit për obligimet e institucioneve arsimore për zbatimin e Udhëzimit Administrativ QRK 05/2013 parandalimin dhe ndalimin e formave rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë10

MASHT në fund të vitit 2013 (24.12.2013) ka miratuar raportin përmbledhës lidhur me obligimet e institucioneve arsimore (MASHT, DKA dhe shkollat për zbatimin e Udhëzimit Administrativ QRK 05/2013 parandalimin dhe ndalimin e formave rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë.

Në këtë raport janë përcaktuar intervenimet në funksion të zbatimit të UA 05/2013, sipas përgjegjësive institucionale. Tabela në vijim pasqyron konkluzionet përmbledhëse të miratuara nga grupi punues.

Institucionet	Intervenimet në funksion të zbatimit të UA 05/2013
MASHT	**Sektori i kurrikulave** ▶ Zbatimi I parimit të gjithëpërfshirjes përmes përkrahjes së shkollave që të sigurojnë plan-programet, orarin mësimor, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimi, si dhe komunikimi me nxënës dhe prindër të jenë në ndjeshme edhe ndaj nevojave, interesimeve dhe mundësive të fëmijëve në rrezik për të braktisur shkollën (përfshirë fëmijët që kombinojnë punën dhe shkollën); ▶ Përfshirja e aspekteve të sigurisë në punë (rreziqet e punës në disa sektorë, masat mbrojtëse, menaxhimi I rreziqeve, etj.), informimi për format e ndaluara të punës për personat 15-18 vjeç dhe të drejtat e punëtorëve në kuadër të fushës kurrikulare jeta dhe puna dhe në kuadër të moduleve për zhvillimin e aftësive jetësore; **Sektori i teksteve dhe mjeteve mësimore** ▶ Harmonizimi I teksteve me kërkesat e reja që dalin nga kurrikulat e reja dhe Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, përfshirë edhe rekomandimet për sektorin e kurrikulave (shih pikat paraprake); **Sektori i zhvillimit profesional të mësimdhënësve** ▶ Zhvillimi i një moduli për përgatitjen e mësimdhënësve në tërheqjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës dhe parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në punë; ▶ Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve për adresimin e nevojave specifike që i kanë fëmijët në rrezik për të braktisur shkollën (përfshirë fëmijët që kombinojnë punën në shkollë) **Sektori i arsimit të përgjithshëm** ▶ Informimi, mobilizimi, mbikëqyrja dhe përkrahja e DKA-ve dhe shkollave në përmbushjen e obligimeve të tyre për zbatimin e UA 05/2013 (shih listën e përgjegjësive për DKA); **Divizioni për komunitete** ▶ Angazhimi I shtuar për sigurimin e përfshirjes së fëmijëve të komunitetit RAE në shkollim; **Divizioni i Arsimit profesional** ▶ Angazhimi I shtuar që shkollat profesionale t'i përgatisin nxënësit për tregun e punës dhe t'i vetëdijësojnë ata për aspektet e sigurisë në punë dhe të drejtat e punëtorëve;

10 Raporti nga MASHT, me numër të protokollit 217, datë 14.01.2014.

Institucionet	Intervenimet në funksion të zbatimit të UA 05/2013
DKA	▶ Informimi, mobilizimi, mbikëqyrja dhe përkrahja e shkollave në përmbushjen e obligimeve të tyre për zbatimin e UA 05/2013 (të listuara më poshtë); ▶ Analizë e vazhdueshme e gjendjes (numrit të fëmijëve në punë të identifikuar nga shkollat, shkaqet dhe pasojat e angazhimit të tyre në punë); ▶ Adresimi I aspekteve që janë përgjegjësi e DKA-ve, si p.sh.: ▶ Sigurimi I transportit jo vetëm në situatat kur distance është e madhe, por edhe në rastet kur siguria nuk është në nivelin e duhur (mungesa e ndriçimit, rreziku nga qentë e rrugës në vendet rurale, apo tjetër); ▶ Organizimi I shujtave ushqimore në shkollat, qoftë përmes funksionalizimit të kuzhinave shkollore, qoftë përmes kontraktimit të shërbimeve përkatëse: vlerësimi I mundësive që fëmijët në nevojë të jenë të liruar nga pagesa e shujtës; ▶ Përmirësimi I infrastrukturës shkollore; ▶ Sigurimi I mundësive që shkollat të organizojnë mësim plotësues për nxënësit me sukses të dobët; ▶ Sigurimi I mundësive për mësim të përshpejtuar për fëmijët të cilët kanë braktisur shkollën për një periudhë më të gjatë; ▶ Ngritja e problemeve të evidentuara (që nuk janë përgjegjësi e DKA-ve dhe Shkollave) tek autoritetet përkatëse komunale për angazhim të shtuar (Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport; Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Inspektoratit, etj.); ▶ Pjesëmarrja aktive dhe ngritja e problemeve të evidentuara në takimet koordinuese me partner (Komunitetet Lokale të Veprimit, Komunitetet Lokale të Sigurisë, Task forcat, etj.) apo në takimet tjera që mund të iniciohen nga vetë DKA-të;
Shkollat	▶ Hapja ndaj komunitetit dhe ndjeshmëri e shtuar ndaj problemeve të komunitetit ku vepron shkolla; ▶ Evidentimi i rasteve të fëmijëve të përfshirë në format e rrezikshme të punës (të listuara në Aneks të UA 05/2013) për nevoja të DKA dhe MASHT; ▶ Planifikimi i mbështetjes së individualizuar edukative për tërheqjen e fëmijëve nga puna; ▶ Referimi i rasteve të fëmijëve të përfshirë në format e rrezikshme të punës (të listuara në Aneks të UA 05/2013) në Qendrën për Punë Sociale për trajtim të mëtejmë; ▶ Përcjellja e trajtimit të mëtejmë të rasteve të referuara nga QPS apo partnerët tjerë, përmes informative kthyese nga partnerët ku janë referuar rastet; ▶ Aplikimi pakos edukative për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes; ▶ Identifikimi i barrierave të qasjes në arsim në nivel shkolle, planifikimi I intervenimeve në nivel shkolle dhe propozimi i masave në kuadër të planeve zhvillimore për DKA dhe MASHT; ▶ Sensibilizim I nxënësve për problemin dhe inkurajimin e Grupeve për të Drejtat e Fëmijëve për përpilimin e materialeve të ndryshme sensibilizuese, si posterë, broshura dhe fletëpalosje dhe për organizimin e aktiviteteve të ndryshme për përkrahje shoku – shokun; ▶ Këshillimi i prindërve ose kujdestarëve dhe anëtarëve të familjes për rreziqet e aktiviteteve të caktuara punuese dhe efektet e mundshme të këtyre rreziqeve në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve; ▶ Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me ofruesit tjerë të shërbimeve dhe partnerët (policinë, QPS, OJQ, bizneset, etj., që ofrojnë programe edukative dhe që kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve) me qëllim largimin nga puna të fëmijëve që kombinojnë shkollën dhe punën apo/dhe kthimin dhe integrimin e fëmijëve të cilët kanë braktisur shkollën;

Shtojca 2:

Pjesë nga raporti përmbledhës mbi gjetjet nga monitorimi dhe mentorimi i DKA-ve dhe shkollave, lidhur me funksionimin e EPRBMSH[11]

Raporti është hartuar nga Grupi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës në nivel të MASHT.

Raporti përmbledh anën legjislative dhe operative të punës së MAShT me partnerët e vet si dhe gjetjet nga procesi i monitorimit dhe mentorimit në 21 komuna të Republikës së Kosovës, mbi zbatimin e politikave kundër braktisjes së shkollimit në praktikën e përditshme të shkollave, dhe DKA-ve.

Referuar raportit për monitorimin dhe mentorimin e shkollave dhe DKA-ve, respektivisht i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollave (EPRBMSH), në fokus ishin dy objektiva:

- Identifikimi i gjendjes për sa i përket themelimit dhe funksionimit të EPRBMSH, si dhe
- Mbështetja e shkollave dhe DKA-ve në funksionalizimin e këtyre mekanizmave

Kjo qasje kishte për qëllim adresimin e barrierave që e cenojnë gjithëpërfshirjen në arsim, duke ngritur kapacitetet e shkollave në identifikimin, raportimin dhe trajtimin e rasteve në rrezik të braktisjes.

Vlerësimi i mekanizmave dhe i përkushtimit institucional për garantimin e vijueshmërisë së rregullt të shkollimit në arsimin e obliguar dhe si dhe për matjen dhe adresimin e faktorëve të rrezikut që e cenojnë shkollimin e fëmijëve tanë, ishte prioriteti i vendosur nga Grupi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës në nivel të MASHT.

Përmbledhje e gjetjeve në DKA

Duke iu referuar pyetjeve dhe përgjigjeve të pranuara, shoqëruar me faktet e ofruara në terren, raporti tregon se 19 komuna e zbatojnë U.A për themelimin dhe funksionimin e ekipeve dhe rrjedhimisht i kanë themeluar ekipet dhe i përdorin doracakët. Ndërkaq 2 DKA (Dragashi, Prishtina) ende nuk i kanë themeluar ekipet, prandaj qasja e tyre ndaj problemit të braktisjes së shkollimit është vetanake e jo uniforme sipas politikave të përcaktuara dhe sistemit të ndërtuar.

Përmbledhje e gjetjeve në shkolla

Sipas raportit, për dallim nga DKA-të, shkollat qëndronin më mirë për sa i përket themelimit dhe funksionimit të ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollave. Nga 25 shkollat e monitoruara, 24 e zbatonin U.A . 19/2012, i kishin themeluar ekipet, por jo të gjitha praktikonin doracakët dhe instrumentet për identifikim, trajtim dhe referim të rasteve në rrezik të braktisjes. Si rrjedhojë e kësaj qasjeje, rastet i trajtonin dhe i evidentoni në mënyrën e vet por jo sipas instrumenteve mbi bazën e të cilave krijohen dosjet dhe bartet informacioni në SPH/ SMIA (me disa përjashtime).

11 Më gjerësisht shih: https://ëëë.childrights-ks.org/site/assets/files/1408/raporti_monitorues_mbi_funksionimin_e_eprbmsh_a5.pdf

Përfundimet

Politikat e parandalimit, identifikimit, trajtimit dhe referimit të rasteve në rrezik të braktisjes dhe ato që e kanë braktisur shkollimin janë mjaft të konsoliduara dhe përmbajtjesore. MAShT me partnerët e vet dhe së fundmi me UNICEF ECMI kanë krijuar një partneritet të mirë në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe cilësor për trajtimin e kësaj problematike. Mbështetja e deritanishme e shkollave dhe DKA-ve ka rezultuar me situatën që e reflekton raporti. Tashmë DKA-të dhe shkollat e dinë se duhet t`i kenë funksionale këto EPRBMSH, meqë gjatë kësaj periudhe u monitoruar dhe u mbështetën DKA-të dhe disa shkolla.

Që ky sistem të jetësohet siç është pretenduar me U.A dhe instrumente përcjellëse lipset ende të punohet me bazë në shkollë ngase aty është burimi i inicimit të veprimeve, por edhe i evidentimit të problemeve në terren. Natyrisht që DKA –të kanë nevojë të jenë më të fokusuara në nxitjen e bashkëpunimit dhe koordinimit 39 ndërsektorial, ngase karshi rasteve në nevojë, meqë lipsen veprimet dhe shërbimet komunale, të cilat janë të mandatuara me legjislacionin në fuqi.

Përgjithësisht, në të gjitha nivelet duhet të ketë sensibilizim të mirëfilltë për rolet, detyrat dhe përgjegjësitë që i kemi për të siguruar gjithëpërfshirjen në arsim cilësor.

Rekomandimet

Bazuar në situatën dhe nevojat e evidentuara në shkolla dhe DKA, duke pretenduar fuqizimin e mekanizmave për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, siç e kemi cakun e përcaktuar në Plan Strategjik të Arsimit në Kosovë, po i listojmë rekomandimet si në vijim.

Rekomandimet për shkollë:

- Drejtorët e shkollave të kujdesen për ta mbajtur aktiv dhe funksional Ekipin për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës (EPRBMSH);
- Kujdestarët e klasave të ndihmojnë procesin e identifikimit e hershëm të rasteve në rrezik dhe t`i adresojnë ato te EPRBMSH;
- EPRBMSH të dokumentojë veprimet e veta, në formë fizike (procesverbalet e takimeve, dosjet e rasteve) dhe online në SPH, sipas instrumenteve të përcaktuara në doracak;
- EPRBMSH, në koordinim me organet e shkollës, të promovojnë punën e tyre në drejtim të parandalimit dhe reagimit efikas ndaj braktisjes dhe rasteve në rrezik;
- Drejtorët e shkollave të mbajnë aktiv këshillin e prindërve dhe atë të nxënësve për të krijuar partneritetin e duhur në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes;
- Drejtorët e shkollave të koordinohen me aktivet profesionale, por edhe me partnerë të ndryshëm qeveritarë e joqeveritarë për realizimin e aktiviteteve shtesë (debateve, ligjëratave mbi zhvillimet në arsim dhe barrierat në kontekstin e shkollave).

Rekomandimet për DKA:

- DKA të sigurojë që EPRBM në nivel komunal të jetë aktiv dhe funksional në shërbim të trajtimit efikas të rasteve që referohen nga shkollat, duke marrë kontributin e duhur të sektorëve të tjerë (të mirëqenies, shëndetësisë, sigurisë etj), sipas specifikave të rasteve të veçanta;

- DKA ta integrojë çështjen e parandalimit dhe reagimin ndaj braktisjes në planin e komunës ose të hartojë plan të veçantë veprimi në nivel komune, me qëllim të adresimit të barrierave të qasjes në arsim;
- DKA të sigurojë buxhet për mbështetjen e aktiviteteve të ekipeve në nivel shkollash;
- DKA të identifikojë dhe koordinohet me partnerë nga shoqëria civile për të mbështetur zbatimin e politikave në adresim të problemit të braktisjes së shkollimit;
- DKA të mbajë aktiv Këshillin e Prindërve dhe atë të nxënësve për të krijuar partneritetin e duhur në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes.
- Koordinatorët për gjithëpërfshirje të koordinohen me EPRBMSH në adresimin e problemit të braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë.

Rekomandimet për MASHT:

- MAShT të fuqizojë EPRBMSH në nivel nacional, duke e bërë atë multidisiplinar;
- MAShT, respektivisht shërbimet e inspektoratit të shtojnë vëmendjen në mbikëqyrjen e zbatimit të politikave nacionale kundër braktisjes së shkollimit;
- MAShT të mbështesë DKA-të dhe shkollat për fuqizimin e EPRBMSH;
- MASHT të vazhdojë koordinimin me partnerët e vet në trajtimin e problemit të braktisjes dhe fuqizimin e sistemit për paralajmërimit të hershëm të braktisjes.

Shtojca 3:

Korniza e kritereve të cilësisë së performancës së shkollës

PARIMET E KKAP	FUSHAT E PERFORMANCËS SË SHKOLLËS				
	MENAXHIMI DHE QEVERISJA	KULTURA DHE MJEDISI	MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA	ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE	PERFORMANCA E NXËNËSVE
	KRITERET E VLERËSIMIT				
GJITHËPËRFSHIRJA	1.1 Organet e qeverisjes janë funksionale dhe efektive në përfaqësimin e interesave të komunitetit të shkollës	1.1 Objekti dhe hapësirat përcjellëse të shkollës janë të qasshme, të sigurta, të shëndetshme dhe miqësore	1.1 Shkolla siguron përfshirjen e nxënësve dhe prindërve në aktivitetet mësimore	1.1 Menaxhmenti i shkollës, në planifikimin e ZhPM, përfshin nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit	1.1 Nxënësit ushtrojnë përgjegjësitë e veta sociale e qytetare në klasë, në shkollë dhe në komunitet
ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE	1.2 Shkolla ka në fokus të orientimit strategjik zhvillimin e kompetencave të nxënësve	1.2 Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave	1.2 Aktivitetet mësimore mundësojnë mbështetje të diferencuar të nxënësve për zotërimin e kompetencave dhe zhvillimin e potencialit	1.2 Praktikat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve	1.2 Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore plotëson pritshmërinë e vendosur me KB
MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA E INTEGRUAR	1.3 Organet profesionale të shkollës janë funksionale dhe efektive në jetësimin e mësimit të integruar	1.3 Mjedisi dhe kultura e punës së shkollës janë në funksion të nxënies së integruar dhe jetësimit të kurrikulës	1.3 Përmbajtjet dhe aktivitetet mësimore janë në funksion të qasjes së integruar	1.3 Praktikat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të mësimdhënies së integruar	1.3 Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare plotëson pritshmërinë e vendosur me KB
AUTONOMIA DHE FLEKSIBILITETI	1.4 Prioritetet e zhvillimit të shkollës pasqyrojnë vizionin e saj, nevojat e nxënësve dhe rezultatet e vetëvlerësimit	1.4 Shkolla ka praktika të konsoliduara të përfshirjes së gjithë komunitetit shkollor në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit fizik	1.4 Autonomia për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje shfrytëzohet në mënyrë efektive	1.4 Shkolla shfrytëzon në mënyrë efikase resurset e saj për aktivitetet e ZhPM	1.4 Nxënësit janë të angazhuar në aktivitete ekstra-kurrikulare
PËRGJEGJËSIA DHE LLOGARIDHËNIA	1.5 Udhëheqja e shkollës udhëheq dhe monitoron zbatimin e PZhSh dhe politikave arsimore	1.5 Shkolla ofron një mjedis të sigurt dhe mundësues për realizim të të nxënit efektiv	1.5 Shkolla është e angazhuar për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënit	1.5 Shkolla mbikëqyrë ndikimin e ZhPM në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies	1.5 Nxënësit janë të angazhuar në menaxhimin e përparimit vetjak

Shtojca 4:

Listë kontrolli për analizën e punës së Ekipeve për Parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit

Komuna:			
Shkolla:			
Funksionimi i EPRBM,	**Po**	**Jo**	**Komente/ Dëshmitë**
Vendimi në nivel shkolle për themelimin e EPRBM është marrë			
Detyrat dhe përgjegjësitë e EPRBM, si dhe dispozitat që krijojnë kushte për punën e ekipit janë përcaktuar në vendim			
Plani i punës është përgatitur nga EPRBM			
Plani i punës përmban aktivitetet kryesore për PRBM, afatet kohore për realizimin e aktiviteteve dhe bartësit e tyre			
Takimet e EPRBM mbahen në baza tre mujore			
Identifikimi i fëmijëve/nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës, braktisës apo që nuk janë regjistruar **në shkollë dhe menaxhimi i rasteve**	**Po**	**Jo**	**Komente/ Dëshmitë**
Pajtueshmëria e shkollës /EPRBM për listën e treguesve të rrezikut është arritur			
Fletë-identifikimi i nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës është shpërndarë tek kujdestarët e klasave			
Lista e evidencave të nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës është përditësuar			
Menaxherët e rastit për nxënësit e identifikuar në rrezik të braktisjes së shkollës janë caktuar			
Procesi i menaxhimit të rastit ndjek 9 hapat e përcaktuar me udhëzuesin për EPBRM			
Menaxhimi i secilit rast përcillet me fletë-evidentimin individual, planin e menaxhimit të rasteve, dhe për rastet e nevojshme me fletën referuese me arsyetime përcjellëse			
Monitorimi i transferimit nga shkolla bëhet sipas procedurave dhe formularëve zyrtarë të kalimi nga shkolla në shkollë (Me qëllim të mosngatërrimit të rasteve të braktisjes me ato të transferit)			

Strategjitë për parandalimin e braktisjes në nivel të shkollës	Po	Jo	Komente/ Dëshmitë
Monitorimi i vijueshmërisë së nxënësve në shkollë bëhet në baza të rregullta			
Njoftimi tek mekanizmat përkatës për mosvijueshmërinë e nxënësit/ve në shkollë bëhet rregullisht			
Procedurat për transferim të nxënësit nga shkolla në një shkollë tjetër dhe anasjelltas janë respektuar			
Nxënësit mentorohen nga mentorët e caktuar nga shkolla			
Nxënësit marrin mbështetje në mësim (mësim plotësues, orë shtesë në gjuhë, orë plotësuese, ndihmë në detyra të shtëpisë etj.)			
Masat të lehtësimit të kalimit ndërmjet klasave dhe niveleve ndërmerren çdo vit shkollor			
Zbatohen strategji të tjera në varësi të rasteve në rrezik të braktisjes së shkollës			
Evidencat e bashkëpunimit dhe rezultateve me ofrues shërbimeve (Qendra për punë sociale, Qendra të mjekësisë familjare, OJQ, etj.)për menaxhimin e rasteve të nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës janë të përditë-suara në varësi të rasteve			
Raportimi	**Po**	**Jo**	**Komente/ Dëshmitë**
Raportimi në modulin e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm (SPH) bëhet me kohë dhe sipas procedurave të përcaktuara me këtë modul (SMIA - SPH)			
Raportet e punës së EPRBM përditësohen në çdo periudhë mësimor/ gjysmëvjetorit			
Raportet përmbajnë informacion të mjaftueshëm për punën e EPEBM *(për identifikimin e fëmijëve jashtë shkolle, në rrezik për braktisje dhe të atyre që kanë braktisur; menaxhimin e rasteve dhe sukseset e arritura në nivel shkolle dhe me partnerë)*			
Raportet s për DKA, MASH dhe IA përmbajnë informacione të mjaftueshme sipas sistemit të paralajmërimit të hershëm dhe sipas kërkesave specifike			

Shtojca 5:

Formulari me listën e pyetjeve sipas indikatorëve relevantë për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes

Lista e pyetjeve sipas indikatorëve relevantë për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes					
Shkolla:_____; Komuna:_____				Data: _____	Inspektori _____
Nr.	Pyetje/ kërkesa	Pikat kryesore të theksuara	Nënpyetje	Pikat kryesore të theksuara	Komente
1.	Si funksionon EPRBM në shkollën tuaj? Cilat janë arritjet kryesore?		*A ka vështirësi? Nëse po, cilat janë ato?*		
2.	Sa takime i ka mbajtur ekipi në këtë vit e sa vitin e kaluar?		*A ka procesverbale, listë të pjesëmar-rjes?*		
3.	A e keni në përdorim Doracakun për ekipet shkollore për paran-dalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar. (MASHT,UNICEF, ECMI dhjetor 2014, tashmë i rishikuar sipas U.A 08/2018))		*A ka vështirësi në të kuptuarit e udhëzimeve dhe në përdorimin e instrumenteve sipas doracakut?*		
4.	Çfarë është e përvoja e juaj në përdorimin e modulit të Sistemit për Paralajmërim të Hershëm?		*Si përdoren të dhënat për të orientuar punën e mëtejme?*		
5.	A keni pasur raste të braktisjes që i ka trajtuar ekipi?		*Nëse po, sa raste? Cilat ishin shkaqet e braktisjes? Sa është arritur që të kthehen në shkollë?*		
6.	A keni pasur raste të mosregjis-trimit të fëmijëve që i ka trajtuar ekip, fëmijë të moshës shkollore në zonën e mbulimit të shkollës tuaj?		*Nëse po, sa raste? Cilat ishin shkaqet e mosregjistrimit? Sa prej tyre dhe si është arritur të regjistrohen?*		
7.	A ka raste fëmijëve/nxënësve që kanë problem me transportin, apo atë e organizon mirë komuna?		*Si ndihmohen rastet kur nuk ka transport të rregulluar?*		

Lista e pyetjeve sipas indikatorëve relevantë për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes					
Shkolla:_____; Komuna:_____				Data: _____	Inspektori _____
Nr.	Pyetje/ kërkesa	Pikat kryesore të theksuara	Nënpyetje	Pikat kryesore të theksuara	Komente
8.	A ka siguri të mjaftueshme për nxënës gjatë vajtje –ardhjes, shkollë-shtëpi?		*Po në shkollë a indikacione të dhunës?* *Nëse po, në çfarë relacionesh?*		
9.	A keni ndonjë nxënës përfitues të bursës komunale? komuna fonde për bursa shkollorë		*Nëse po, sa është numri i përfituesve?* *Meshkuj:* *Femra:*		
10.	A ka rritje të përfshirjes së fëmijëve në klasë parafillore?		*Nëse po, sa është rritja dhe si rezultat i kujt (cilave veprime)?*		
11.	Si reflektohet gjithëpërfshirja e nxënësve në proceset e mësimit?		*Cilat janë praktikat e identifikimit dhe punës së nxënësve me nevoja të veçanta?*		
12.	A po e zbatoni protokollin për parandalim dhe referim të dhunës në shkolla		*A e përdorni modulin e incidentit dhe manualet didaktike?*		
13.	A keni nxënës të panotuar në fund të vitit paraprak?		*Nëse po, pse dhe si raportohen ata?*		
14.	Si i përdorni të dhënat tuaja që flasin për barrierat në pjesëmarrje në arsim dhe përfitim nga procesi i mësimdhënies?		*Çfarë bëni për të rritur arritjen e nxënësve në lëndë të caktuara apo edhe të rezultateve në nivel klasash e shkolle?*		
15.	Tjetër (shëno pyetje)				

Shtojca 6:

Përmbledhje e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve në raportet e VJPSH

Kjo përmbledhje është shkëputur nga gjetjet e studimit *Vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollës si mekanizëm për sigurimin e cilësisë, gjendja dhe perspektiva* (Kërkime pedagogjike, IPK 2020),

Referuar udhëzuesit për VJPSH, në raportin e VJPSH-së gjetjet kryesore organizohen në nivel të: (i) vlerësimit të përgjithshëm të performancës së shkollës; (ii) vlerësimit të veçantë për fushën e cilësisë Performanca e nxënësve, duke përfshirë fokusin në zotërimin e kompetencave kryesore të kurrikulës; (iii) vlerësimit të fushave tjera të cilësisë dhe kritereve të cilësisë sipas fushave përkatëse; dhe (iv) përmbledhjes së anëve të forta, sfidave dhe trendit të zhvillimit të shkollës.

Në të gjitha raportet e VJPSH-së, të analizuara në kuadër të këtij hulumtimi, janë të përfshira gjetjet kryesore dhe rekomandimet për shkollat e përfshira në VJPSH. Dallimet janë të dukshme në strukturën e organizimit të gjetjeve kryesore, përmbajtjen e përshkrimit të gjetjeve kryesore, ndërlidhjen e gjetjeve kryesore me kriteret e cilësisë, treguesit e performancës së shkollës sipas kritereve të cilësisë dhe me të dhënat e përgjithshme për shkollën. Dallimet janë të dukshme edhe në mënyrën e përcaktimit dhe përshkrimit të rekomandimeve për shkollën, numrin e rekomandimeve dhe afatet e zbatimit të tyre. Dallimet përshkruhen si në vijim:

- Në katër raporte të VJPSH-së të analizuara, gjetjet kryesore janë organizuar sipas orientimeve të dhëna në udhëzuesin për VJPSH, përkatësisht në pjesën e strukturës së raportit të VJPSH-së për gjetjet kryesore nga vlerësimi i jashtëm. Në këto raporte fillohet me performancën e përgjithshme të shkollës, vazhdohet me performancën e nxënësve (por pa një fokus të veçantë në zotërimin e kompetencave kryesore të kurrikulës), shkallën e cilësisë së performancës në fushat tjera të cilësisë, konstatimet për gjetjet kryesore sipas fushave të cilësisë (por pa një fokus të veçantë në konstatime kryesore në raport me kriteret e cilësisë), dhe përfundohet raporti me anët e forta, anët e dobëta dhe rekomandimet për shkollat përkatëse.

- Në dy raporte të VJPSH-së të analizuara, gjetjet kryesore fillojnë me performancën e përgjithshme të shkollës, pastaj vazhdohet me përshkrimin e gjendjes në secilin tregues të performancës për kriteret përkatëse të cilësisë, përcaktimin e shkallës së vlerësimit për secilin kriter të cilësisë. Këto dy raporte përfundohen me rekomandimet për përmirësim dedikuar shkollës përkatëse.

- Në tri raporte të VJPSH-së të analizuara, gjetjet kryesore fillojnë me vlerësimin për performancën e përgjithshme të shkollës, pastaj vazhdohet me përshkrimin e gjendjes në secilën fushë të cilësisë (por pa një fokus të veçantë në kriteret e cilësisë apo treguesit e performancës, me kombinime të dy këtyre aspekteve) dhe të aspekteve që duhet të përmirësohen për secilën fushë të cilësisë, si dhe me përcaktim të shkallës së vlerësimit për secilën fushë të cilësisë. Në vazhdim të këtyre raporteve gjejmë një përmbledhje të vlerësimit të përgjithshëm të shkollës dhe rekomandimet për përmirësim dedikuar shkollës përkatëse.

- Në tri raporte të VJPSH-së gjetjet kryesore janë të organizuara sipas instrumentit të vlerësimit të jashtëm, pjesës së instrumentit ku vlerësimi bëhet në nivel të fushave të cilësisë dhe vlerësimit të përgjithshëm. Në këto tri raporte janë përfshirë aspekte si në vijim: (i) Përcaktimi i shkallës së cilësisë sipas fushave të cilësisë; (ii) Përshkrimi përmbledhës i gjetjeve për secilin kriter të cilësisë, në kuadër të fushës përkatëse; (iii) Dëshmitë/evidencat; (iv) Komente/Sqarime shtesë; (v) Përshkrimi i përgjithshëm i performancës; (vi) Përparësitë dhe dobësitë e identifikuara; dhe (vii) Rekomandimet dhe afate për zbatimin e tyre.

Në asnjërin prej raporteve të pranuara për analizë dhe shqyrtim, në kuadër të këtij hulumtimi, nuk janë bashkëlidhur tri shtojca të dokumenteve të sugjeruara me udhëzuesin për VJPSH: Shtojca 1: Instrumenti i vlerësimit të jashtëm me të dhënat e evidentuara; Shtojca 2: Raporti i vetëvlerësimit të shkollës; dhe Shtojca 3: Plani zhvillimor i shkollës.

Përveç dallimeve në strukturën e raportit të VJPSH-së, në pjesën e raportit për gjetjet kryesore dhe rekomandimet ka dallime të theksuara në përmbajtjen e përshkrimit të gjetjeve kryesore dhe në formën dhe përmbajtjen e formulimit të rekomandimeve për përmirësim. Dallimet ilustrohen në shembujt në vijim, duke filluar me përshkrimin e gjendjes së shkollës në raport me treguesit e performancës, për të vazhduar pastaj me vlerësimet në nivel të kritereve të cilësisë, fushave të cilësisë, dhe në nivel të përgjithshëm.

Për treguesin e performancës 1.1.1. *Vlerësimet e brendshme të shkollës janë realizuar me pjesëmarrjen e gjithë komunitetit shkollor*, janë dhënë përshkrime të ndryshme në raportet e vlerësimit:

> *Raporti 1. Shkolla ka bërë vetëvlerësim për herë të parë, andaj në PZHSH ka pasqyruar të dhëna të identifikuara, qoftë për misionin apo vizionin, qoftë për nevojat tjera të nxënësve.*
>
> *Raporti 3. Shkolla ka realizuar vlerësimin e brendshëm, ka zbatuar planifikimin zhvillimor të shkollës, interesat e nxënësve nuk janë realizuar, sidomos te Kurrikula me zgjedhje.*
>
> *Raporti 7. Koordinatori i cilësisë me ekipin e shkollës për vlerësim të brendshëm të shkollës ka hartuar tre pyetësorë. Struktura e pyetësorëve është e mirë. Pyetjet janë të ndara, për fusha të cilësisë, pyetësorët janë analizuar për të nxjerrë rekomandime.*
>
> *Raporti 11. Përfshirja e aktorëve në vlerësimin e brendshëm ka qenë e mirë, por nga raporti i VBSH-së dhe kontrollimi i dosjes së VBSH-së shihet se nuk është arritur që të prezantohet një gjendje reale e performancës së shkollës.*

Siç shihet në shembujt e dhënë nga disa raporte të vlerësimit, vetëm në raportin e vlerësimit nr. 11, në pjesën e parë të përshkrimit të gjendjes pasqyrohet thelbi i gjendjes për treguesin e performancës: 1.1.1. *Vlerësimet e brendshme të shkollës janë realizuar me pjesëmarrjen e gjithë komunitetit shkollor.*

Në përshkrimet e bëra për tregues të tjerë të performancës së shkollës, në kuadër të kritereve të cilësisë përkatëse, shpesh gjenden formulime që nuk e adresojnë drejtpërdrejt treguesin përkatës, apo janë të njëjta, edhe pse autorët e raporteve janë të ndryshëm. Kështu për treguesin *4.1.1. Plani i shkollës për zhvillimin profesional të mësimdhënësve bazohet në Planin individual të mësimdhënësve për zhvillim profesional, prioritetet e shkollës, performancën e mësimdhënësve dhe performancën e nxënësve,* formulimi i përshkruar për gjendjen e shkollave në raport me këtë tregues të performancës është i njëjtë në 6 raporte të vlerësimit për shkolla të ndryshme. Përshkrimi në këto 6 raporte është si në vijim: *Mësimdhënësit nuk kanë plane individuale të zhvillimit profesional, shkolla ka hartuar një tabelar me të dhëna për trajnimet e mësimdhënësve, por nuk ka plan të zhvillimit profesional të mësimdhënësve*.

Për vlerësimin e kritereve të cilësisë dhe treguesit e performancës, në fushën e cilësisë Mësimdhënia dhe nxënia, evidencat dhe përshkrimet e vlerësimeve në masë të madhe mbështeten në gjetjet e siguruara përmes protokollit të vëzhgimit të mësimdhënësve në klasë, të cilin e aplikon IA. Edhe në këtë fushë, si në fushat tjera të cilësisë, gjejmë dallime në vlerësimet përshkruese në mes të raporteve të analizuara, të cilat në të shumtën e rasteve nuk adresojnë drejt pesë kriteret e cilësisë në këtë fushë dhe nuk ofrojnë përmbledhje të qartë të vlerësimit në bazë të gjendjes së përgjithshme në këtë fushë të cilësisë. Këtë e ilustrojnë shembujt në vijim:

> *Raporti 1. Mësimdhënësit bashkëpunojnë në kuadër të organeve profesionale në procesin e planifikimit dhe zbatimit të qasjeve dhe metodave adekuate për zhvillimin e kompetencave kryesore. Metodat dhe strategjitë e mësimdhënies dhe nxënies që praktikohen në klasë dhe jashtë saj janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve. Përmbajtjet mësimore janë në funksion të arritjes së rezultateve të nxënies*

për fushën përkatëse... Përkushtimi i shkollës për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor duhet të shihet në formimin e mekanizmave të vendosur për monitorim dhe raportet e tyre për ngritjen e cilësisë dhe efektivitetit të procesit mësimor. Shkolla nuk ka shërbim të pedagogut dhe psikologut (shkolla ka 155 nxënës).

Raporti 5. Bazuar në VJSH të shkollës, si dhe bazuar në monitorimet e orëve mësimore, gjithsej të realizuara janë 8 orë mësimore, EVJSH-ja vlerëson procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në këtë shkollë mirë, me mundësi përmirësimi, kërkohet përkushtim më i madh nga mësimdhënësit, krijim të kushteve më të mira nga shkolla, duke filluar sigurimin e mjeteve të konkretizimit, disa laptopë, video-projektor, nga një për fushë kurrikulare.

Raporti 10. Të gjithë mësimdhënësit, të cilët janë në marrëdhënie të rregullt pune, kanë kualifikimet përkatëse për lëndët mësimore që mbajnë. Shumica prej tyre kanë të kryera edhe trajnime bazike në fushën e mësimdhënies. Performanca e tyre në mësim është në nivel të pranueshëm.

Në disa raste, vlerësimet në nivel të fushave të cilësisë nuk mbështeten duke u bazuar në gjetjet e evidentuara në raport me të gjithë treguesit e performancës, për secilin kriter të cilësisë së fushës përkatëse, por mbështeten vetëm në raportin e vetëvlerësimit të shkollës dhe nuk pasqyrojnë në mënyrë të drejtë kriteret e cilësisë së fushës përkatëse të cilësisë. Këtë e ilustron shembulli në vijim nga raporti nr. 8:

Në bazë të dëshmive të paraqitura nga Ekipi për vlerësimin e brendshëm të shkollës për fushën e cilësisë - Performancës së nxënësve, ekipi i vlerësimit të jashtëm konstaton: Nxënësit kanë aftësi për planifikim, bashkëpunim dhe organizim të aktiviteteve brenda shkolle dhe jashtë saj, sipas talentit profesional dhe shkathtësive, preferencave të tyre (ekipe sportive, muzikore dhe të historianëve, por jo në ato të biologëve të rinj ose kimisteve të rinj) etj. Shkolla nuk ka dëshmi të mjaftueshme të përkrahjes së aktiviteteve të nxënësve në shkollë për arritshmërinë e nxënësve në zotërimin e kompetencave për realizimin aktiviteteve ekstrakurrikulare.

Referuar udhëzuesit për VJPSH, vlerësimi i performancës së përgjithshme të shkollës përmban një përmbledhje të gjendjes së konstatuar në nivel të fushave të cilësisë që kanë qenë objekt i vlerësimit të shkollës. Ky vlerësim duhet të bëhet nga perspektiva e ndikimit që kanë pasur praktikat shkollore te nxënësit dhe nxënia e tyre. Mirëpo, raportet e VJPSH-së, të analizuara për këtë hulumtim, nuk e reflektojnë këtë. Në tri raporte, në të cilat është dhënë vlerësimi i performancës së përgjithshme, gjejmë konstatime të përgjithshme, të cilat nuk reflektojnë ndikimin që kanë pasur praktikat shkollore në nxënësit dhe në nxënien e tyre. Këtë e ilustrojnë shembujt në vijim, të cilët prezantojnë pjesë nga vlerësimi i përgjithshëm i performancës së shkollës:

Raporti nr. 10. Përzgjedhja e kurrikulës me zgjedhje është bërë në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi. Puna e aktiveve profesionale nuk është e rregullt, procesverbalet i kanë mjaft formale, në të dyja nivelet, formimi i aktiveve nuk është në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Nuk ka shënime se mësimdhënësit, për hartimin e programeve të punës, shërbehen me rezultate të nxënësve në mësim. Në procesin e mësimdhënies, te disa mësimdhënës, dominon forma tradicionale e punë me nxënës.

Raporti nr. 1. Shkolla i ka përmbushur obligimet deri në një masë të caktuar. Ka formuar organet drejtuese të shkollës, ka hartuar PZHSH, ka formuar ekipin për vlerësim të brendshëm EVB, ekipi ka punuar dhe hartuar raportin e vetëvlerësimit të shkollës në bazë të planit të veprimit dhe gjetjeve gjatë vlerësimit të brendshëm. Nuk ka formuar Këshillin për mbrojtjen dhe të drejtat e lirive të fëmijëve, nuk ka mbajtur evidencë të funksionimit të Këshillit të prindërve, bashkëpunimit të prindërve. Edhe kontributi që është bërë në shkollë nga radhët e prindërve nuk ka evidencë. Nuk është respektuar hierarkia e raportimit të rregullt, nuk ka plan për mësim shtues dhe plotësues për të intervenuar me kohë që nxënësit të arrijnë rezultatet e përcaktuara me KB. Vizioni i shkollës është i qartë dhe është prezantuar në hapësirat e shkollës, i cili mund të lexohet nga mësimdhënësit, nxënësit, prindërit.

Referuar udhëzuesit për VJPSH, me rastin e vlerësimit të përgjithshëm, identifikohen edhe përparësitë dhe dobësitë e performancës së shkollës. Edhe në këtë pjesë gjejmë dallime në gjuhën e formulimit të përparësive, dobësive dhe të rekomandimeve, por edhe në përmbajtjen dhe rëndësinë e tyre, nga ato që lidhen me cilësinë e performancës së shkollës, deri tek ato që nuk lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e performancës, si p.sh.: *respektimi i orarit të ziles*, përparësi e identifikuar në gjysmën e raporteve të VJPSH-ve të analizuara.

Edhe në raport me dobësitë e identifikuara, kemi raporte që drejtpërdrejt listojnë dobësitë që lidhen me *cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies* dhe dobësi të cilat janë të përgjithësuara, si p.sh. *përdorim jo i mjaftueshëm i përgatitjes me shkrim për orën mësimore*, ose dobësi për masa të shkollës, të cilat nuk janë të domosdoshme, si p.sh. *mungesa e kamerave të sigurisë*.

Në anën tjetër, rekomandimet për punën e mëtejme të shkollës, apo masat që duhet të ndërmerren nga shkolla për mirëmbajtjen dhe avancimin e përparësive dhe përmirësimin e anëve të dobëta, respektivisht tejkalimin e sfidave të evidentuara, janë një kërkesë e veçantë për raportet e VJPSH-së. Adresimi i tyre në raportet e VJPSH-së është bërë në varësi të specifikave të shkollës dhe me dallime të mëdha në numrin e rekomandimeve (nga 5 rekomandime që ka raporti i një shkolle, deri në 27 rekomandime në raportin e shkollës tjetër), por edhe në përmbajtjen e tyre, të cilat në raste të caktuara nuk ndërlidhen në përshkrimet me gjetjet kryesore të VJPSH-së. Disa nga formulimet e rekomandimeve janë si në vijim:

- *Drejtoria e shkollës të kontrollojë, të motivojë dhe të ngritë efikasitetin e organeve të shkollës. (afati i zbatimit, janar 2020);*
- *Shkolla duhet të ndërtojë sistem efektiv të administrimit të rezultateve të arritshmërisë, të përcaktuara për fushat kurrikulare, si dhe për pajisjen me kabinete dhe mjete konkretizimi;*
- *Rekomandohet të respektohet mësimi i integruar. Mësimi i integruar në shkollën e mesme të ulët (VI–IX) duhet realizuar nëpërmjet mësimit ekipor. "Mësimi ekipor paraqet formë specifike të organizimit të mësimit për bashkësi të caktuara nxënësish, me bashkëpjesëmarrje të disa mësuesve apo bashkëpunëtorëve profesionalë nga shkolla apo jashtë saj, për të realizuar program të përbashkët pune", informatat si p.sh. mund të shërbeheni në këtë adresë interneti ëëë.bedri-jaka.com.*
- *Angazhim më i madh i të gjithë aktorëve relevantë në përkrahjen e nxënësve për realizimin e projekteve të tyre;*
- *Vlerësimi i brendshëm i shkollës për këtë vit shkollor të bëhet në të gjitha fushat e cilësisë;*
- *Të eliminohen lëshimet në funksionimin e organeve qeverisëse dhe profesionale të shkollës. Afati: në vazhdimësi.*

Në përgjithësi, nëse do t'u referohemi orientimeve në Udhëzuesin për VJPSH për rekomandimet, mund të konstatojmë se në raportet e para të VJPSH-së vërehet një tendencë e ikjes nga orientimet dhe udhëzimet e dhëna për vlerësuesit e jashtëm dhe, për rrjedhojë, një pjesë e madhe e rekomandimeve të mos reflektojnë masat për sigurim të cilësisë dhe në funksion të planifikimit zhvillimor të shkollës.

Shtojca 7:

Pjesë nga disa raporte të VJPSH, në fushën e cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor

Raporti 1. Performanca në nivel të fushës së cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor – e mirë.

- Objekti i shkollës edhe pse i vjetër, është i përshtatshëm për punë. Higjiena është e mirë. Siguria e nxënësve është në nivel të mirë. Nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit nuk paraqesin ndonjë vërejtje për sigurinë e nxënësve në shkollë.
- Trajtimi i prindërve dhe personelit mësimor është në nivel të mirë. Nga të dhënat e siguruara nga kontaktet me ta dhe përmes pyetësorëve të realizuar me nxënës del se ofendimi i nxënësve nuk është dukuri. Mungesa e kabineteve dhe e mjeteve të konkretizimit nuk mundësojnë përmbushje të plotë të kërkesave të nxënësve as në përmbushjen e kompetencave në mësim as në shkathtësi të ndryshme për të cilat kanë talent. Pos një numri të vogël të librave, nuk kanë mjete tjera në dispozicion për mësim apo për aktivitete të ndryshme jashtë mësimore.
- Me aplikimin e kurrikulës se re, deklarohen se ka një bashkëpunim më të madh në mes të mësimdhënësve, por nga dëshmitë – procesverbalet, vërehet se ky bashkëpunim nuk është në nivel të dëshirueshëm.
- Përfshirja e prindërve është vetëm në kuadër të organeve qeverisëse të shkollës. Nga protokolli i vëzhgimit në klasë del se klima në klasë është në nivel të kënaqshëm, nga pesë pikë të mundshme, në nivel të shkollës ka dalë nota mesatare 2.8.

Rekomandimet - Nuk janë dhënë rekomandime që lidhen me EPRBM dhe adresimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit.

Raporti 2. Fusha e cilësisë 2: KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR

Gjithë komuniteti i shkollës ka trajtim të mirë. Prindërit nxënësit dhe personeli ndjehen të përkrahur dhe pjesë të institucionit. Shkolla ka dëshmi të realizimit të pritshmërisë në zotërimin e kompetencave me pjesëmarrje në gara të ndryshme në nivel Komune dhe Republike.

Burimet njerëzore janë të mjaftueshme. Mjedisi fizik, uji i pijshëm, lagështia e ajrit, ajrosja, temperatura janë të favorshme. Në shkollë mungojnë burimet financiare dhe mjetet e konkretizimit për të realizuar suksesshëm kërkesat e parapara më kurrikulat bërthamë.

EVJ ka identifikuar pikat që duhet të përmirësohen:

Shkolla nuk ka evidence për ndonjë vlerësim të organit udhëheqës, të përkrahjes së nxënësve nga organet udhëheqëse të shkollës, të pasqyruara në procesverbal.

Objekti i shkollës është 100 m nga rruga ndër komunale N.N e cila është shumë e ngarkuar dhe nuk ka nënkalim ose mbikalim dhe trotuare. Paraqet rrezik për sigurinë e nxënësve. Shkolla nuk ka bërë kërkesë zyrtare për ndryshimin e gjendjes.

Shkolla është e re por është shumë e dëmtuar. Izolimi, ujësjellësi, dyert, orenditë, mjetet e konkretizimit shihet që kanë qenë në mëshirën e një pakujdesie. Tani gjendja ka filluar të ndryshoj në të mirë. Nuk ka mjaftë aktivitete sociale dhe kreative në shkollë. Drejtoria e shkollës të bëjë kërkesë në komunë për të trajnuar nxënës të klasës. VII,VIII dhe IX në këtë vit, kurse për çdo vit në vijim nxënës nga klasa VII për ndihmë të parë dhe për situata tjera emergjente.

Shkolla nuk ka hartuar rregulloren për shfrytëzimin e mjeteve mësimore.

EVJ ka konstatuar që në shkollë nuk është funksional EPMRB. Nuk ka shënime për braktisjen e shkollës. Higjiena jashtë dhe brenda shkollës nuk është në nivel të duhur. Koha e punës së pastruesve nuk është mirë e sinkronizuar. Nuk ka funksionuar kutia e ankesave sipas rregullores edhe pse është e vendosur në hyrje të shkollës.

Rekomandimet - Nuk janë dhënë rekomandime që lidhen me EPRBM dhe adresimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit.

Raporti 3. Fusha e cilësisë 2: KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR

Kriteri 2.2. Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave

2.2.1 Shkolla nuk ka dëshmi të realizimit të pritshmërisë në zotërimin e kompetencave me pjesëmarrje **në gara të ndryshme në nivel komunal dhe republikan ka vetëm konstatime** të përkrahjes së nxënësve nga organet udhëheqëse të shkollës, të pasqyruara në procesverbal.

2.2.2 EVJ ka konstatuar që në shkollë është funksional EPMRB. EVJ ka konstatuar që shkolla i ka të evidentuara rastet e kalimit nga kjo shkollë në shkollë tjetër. Ka rasteve të migrimit jashtë vendit, por nuk ka raste të braktisjes së shkollës.

2.2.3 Shkolla ka krijuar rrjetin e bashkëpunimit më institucionet komunale, Qendrën për punë sociale, Qendrën e mjekësisë familjare. Shkolla nuk ka bashkëpunim me kryqin e kuq. Nxënësit përkrahen nga OJQ për zhvillimin e kompetencave kryesore.

2.2.4 Shkolla ka dëshmuar së mundëson realizimin e potencialit të nxënësve përmes aktiviteteve ekstrakurrikulare në nivel komune. Shkolla për të arrit avancimin e prirjeve individuale të nxënësve ka ofruar përkrahje të nxënësve me prirje në lami të ndryshme si: Art, muzikë, gara të diturisë, sport etj.

2.2.5 Shkolla nuk i ka ofruar EVJ dëshmi për implementimin e PIA në realizimin e masave efektive në përkrahjen e nxënësve me nevoja të veçanta. Shkolla nuk ka hartuar program për mësim plotësues dhe shtues.

2.2.6 Niveli i braktisjes nxënësve nga shkolla është përshkruar në treguesin 2.2.2.

Shkalla e cilësisë: E papranueshme

Rekomandimet

1. N.N.
2. N.N.
3. Shkolla të formoj ekipin për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së nxënësve, të planifikoj forma të përshtatshme të punës me prindër për avancimin e procesit mësimor.

Raporti 4. Fusha e cilësisë 2: KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR

Kriteri 2.2. Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave

2.2.1 Bazuar në pyetësorin që është realizuar me 10 mësimdhënës për arritje të kompetencave janë shprehur 5 mësimdhënës, ndërsa vlerësime për pak arritje të kompetencave janë shprehur 3 mësimdhënës dhe 2 mësimdhënës janë shprehur se nuk e dijn . Kjo pasqyrë tregon së 5 mësimdhënës kanë shprehur vlerësimin të lartë. Nuk është e qartë në çka është bazuar vlerësimi i tyre.

2.2.2 Vlerësimi është i mirë dhe real.. Është vepruar sipas UA. 7/2011.

2.2.3 Bashkëpunimi i shkollës më faktorët tjerë është vlerësuar i mirë. Por nuk është ofruar ndonjë dëshmi, qoftë edhe nga fletorja e kujdestarisë së shkollës, nuk ka dëshmi për ndonjë analizë që është bërë për ndryshimin e gjendjes në shkollë që vije nga ky bashkëpunim.

2.2.4 Shkolla i mundëson çdo nxënësi angazhimin vullnetar për aktivitetet jashtë kurrikulare dhe janë përmendur (gara, vizita, aktivitete). Nuk kemi një të dhënë për hulumtimin dhe zbulimin e shkathtësive dhe talenteve të reja. Të gjitha këto të arritura janë të natyrës së shkathtësive.

Rekomandimet

Nuk janë dhënë rekomandime që lidhen me EPRBM dhe adresimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit.

Raporti 5. Performanca në nivel të fushës së cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor – e mirë.

Kriteri 2.2. Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave

2.2.1 Shkolla ka ofruar dëshmi të realizimit të pritshmërisë në zotërimin e kompetencave dhe realizmin individual të secilit nxënës. Nxënësit janë pjesëmarrës në gara në nivel komunal, republikan dhe mbarë kombëtare.

2.2.2 EVJ ka konstatuar që në shkollë EPMRB është themeluar me vendim me 16.10.2014, por vendimi është i pa protokolluar. EVJ ka konstatuar ky ekip është jo funksional.

2.2.3 Shkolla ka krijuar rrjetin e bashkëpunimit më institucionet komunale shëndetësore, Qendrën për punë sociale, Qendrën e mjekësisë familjare KFOR-in dhe Organizatën joqeveritare KITÊS dhe policinë e Kosovës.

2.2.4 Shkolla ka dëshmuar së mundëson realizimin e potencialit të nxënësve përmes aktiviteteve ekstrakurrikulare në nivel komune, për të arritur avancimin e prirjeve individuale të nxënësve ofron përkrahje të vazhdueshme nxënësve me prirje në fusha të ndryshme: Në Gjuhën angleze nga Kolegji " N.N." në N.N., shëndeti dhe mirëqenia (sport) etj.

2.2.5 Mësimdhënësit nuk hartojnë dhe zbatojnë PIA në realizimin e masave efektive në përkrahjen e nxënësve me nevoja të veçanta.

2.2.6 Niveli i braktisjes nxënësve nga shkolla është në nivel të ulët, bazuar në procesverbalin e mbledhjes së Këshillit të arsimtarëve nuk ka braktisje të shkollës nga nxënësit.

Shkalla e cilësisë: E pranueshme

Rekomandimet - Nuk janë dhënë rekomandime që lidhen me EPRBM dhe adresimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit.

Raporti 6. Performanca në nivel të fushës së cilësisë: Kultura dhe mjedisi shkollor – Shkëlqyeshëm .

a. Objekti i shkollës edhe pse i vjetër, është i përshtatshëm për punë.

b. Higjiena në ambientin e brendshëm dhe jashtë objektit te shkollës është në nivelin e duhur.

c. Siguria e nxënësve është në nivel të mirë. Nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit nuk paraqesin ndonjë vërejtje për sigurinë e nxënësve në shkollë.

d. Trajtimi i prindërve dhe e personelit mësimor është në nivel të shkëlqyeshëm . Nga të dhënat e siguruara nga kontaktet me ta dhe përmes pyetësorëve të realizuar me nxënës del se ofendimi i nxënësve nuk është dukuri.

e. Me aplikimin e kurrikulës se re, deklarohen se ka një bashkëpunim më të madh në mes të mësimdhënësve, Kjo vërtetohet nga dëshmitë në procesverbale.

f. Përfshirja e prindërve ne vendimmarrje dhe aktivitete ne shkollë ishte ne nivelin e duhur.

Nga protokolli i vëzhgimit në klasë del se klima në klasë është në nivel të shkëlqyeshëm.

Rekomandimet - Nuk janë dhënë rekomandime që lidhen me EPRBM dhe adresimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit.

Raporti 7. Fusha e cilësisë 2: KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR

Kriteri 2.2. Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave

2.2.1 Bazuar në pyetësorin që është realizuar me 15 mësimdhënës për arritje të kompetencave janë shprehur 10 mësimdhënës, ndërsa vlerësime për pak arritje të kompetencave janë shprehur 2 mësimdhënës dhe për një nivel të kënaqshëm janë shprehur 3 mësimdhënës. Kjo pasqyrë tregon së 10 mësimdhënës kanë shprehur vlerësimin të lartë. Nuk është e qartë në çka është bazuar vlerësimi i tyre.

2.2.2 Vlerësimi është i mirë dhe real. Nuk ka mos regjistrim të nxënësve por ka braktisje. Mungon formimi i EPRBM.

2.2.3 Bashkëpunimi i shkollës me faktorët tjerë është vlerësuar i mirë. Por nuk është ofruar ndonjë dëshmi, qoftë edhe nga fletorja e kujdestarisë së shkollës, nuk ka dëshmi për ndonjë analizë që është bërë për ndryshimin e gjendjes në shkollë që vije nga ky bashkëpunim.

2.2.4 Shkolla i mundëson çdo nxënësi angazhimin vullnetar për aktivitetet jashtë kurrikulare dhe janë përmendur (ekspozita, gara, vizita, aktivitete). Nuk kemi një të dhënë për hulumtimin dhe zbulimin e shkathtësive dhe talenteve të reja. Të gjitha këto të arritura janë të natyrës së shkathtësive(mirënjohje në fushën e shkathtësive, investitorëve dhe me rastin e pensionimit të mësimdhënësve).

Rekomandimet - Nuk janë dhënë rekomandime që lidhen me EPRBM dhe adresimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit.

Raporti 8. Fusha e cilësisë 2: KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR

Objekti i shkollës amë ku mësojnë klasat e nivelit të mesëm të ulët është i përshtatshëm për punë, ka edhe sallën e edukatës fizike, në shkollën ku vijojnë mësimin klasat e nivelit fillor, kushtet janë mjaftë të papërshtatshme, ndërsa në PNF-të e kësaj shkolle, kushtet higjieno teknike janë në nivel pak më të mirë. Siguria e nxënësve në shkollë është në nivel të mirë, nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit nuk paraqesin ndonjë vërejtje për sigurinë e nxënësve në shkollë. Nga bisedat me prind, kemi kuptuar se kalimi i rrugëve trenit për në shkollë, nuk është i sigurt.

Trajtimi i prindërve dhe e personelit mësimor është në nivel të mirë. Nga të dhënat e siguruara nga kontaktet me ta dhe përmes pyetësorëve të realizuar me nxënës del se ofendimi i nxënësve është dukuri mjaft e shpeshtë. Nga 22 nxënës të përfshirë në pyetësor, në pyetjen se a përdorin mësimdhënësit ofendime ndaj jush, 8 prej tyre përgjigjen pozitivisht, por edhe prindërit përmes pyetësorit edhe nga takimi me këshillin e nxënësve, thuhet se ka raste të ofendimeve dhe të përdorimit të dhunës, sidomos është e shprehur dhëna e nxënësve ndaj nxënësve. Disa prindër kanë vërejtje në mirëmbajtjen e higjienës në shollë e sidomos në nyjet sanitare (mund të jenë prind të nxënësve të shkollës së vjetër). Edhe në pyetjen për përfshirje e nxënësve në aktivitete të lira, vetëm 5 prej tyre kanë përgjigje pozitive (disa si pjesëmarrje në aktivitete, kanë paraqitur pjesëmarrjen në aktivitete sportive apo në kurse të lëndëve të ndryshme)

Rekomandimet: Të merren masa për zvogëlimin e numrit të mungesave për nxënës.

Shtojca 8 :

Korniza ligjore, politika arsimore, si dhe referencat tjera që janë përdorur për zhvillimin e modulit

- **Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2019). LIGJI NR. 06/L-084 PËR MBROJTJEN E FËMIJËS.** https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844

- **Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës,** Ligji nr. 06/L -046. Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 13 / 10 Gusht 2018, Prishtinë. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17744

- **Mehmeti,** S., Boshtrakaj, L., Bytyqi, L. Zylfiu, H. & Potera, I., (2018). Përvojat e para në vlerësimin e performancës së shkollës në Kosovë. Instituti Pedagogjik i Kosovës. Prishtinë. http://ipkMASHT.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2015/11/Raporti-Pervojat-e-para-ne-vleresimin-e-performances-se-shkolles.pdf

- **Mehmeti,** S., Zylfiu, H., Potera, I., Buleshkaj, O. dhe Lehner-Stift, U. (2016). Manual për sigurimin e cilësisë në shkollë. Bashkimi Evropian – në kuadër të Projektit të Binjakëzimit për Kosovën.

- **Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2021). Plani dinamik i punës kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës (2021).**

- **Ministria e Arsimit,** e Shkencës dhe e Teknologjisë & Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). *Korniza e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë.* IPK, Prishtinë. http://ipkmasht.rks-gov.net/kriteret-dhe-treguesit-e-cilesise-se-performances-se-shkolles/

- **Ministria e Arsimit,** e Shkencës dhe e Teknologjisë. (04/2017). *Udhëzimi Administrativ nr.* 04/2017: *Vlerësimi i performancës në Institucionet e Arsimore.* Prishtinë. http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/4-2017-ua-vleresimin-e-performances-se-institucioneve-arsimore-ne-arsimin-parauniversitar-rotated.pdf

- **Ministria e Arsimit,** e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2011). Udhëzimi administrativ nr. 9/2011 për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave statistikore nga shkollat dhe institucionet parashkollore në arsimin parauniversitar duke përdorur sistemin për menaxhimin e informatave në arsim, 30 dhjetor 2012, http://ëëë.masht-gov.net/advCms/documents/09_UA.pdf

- **Ministria e Arsimit,** e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2014a). *Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar.* (MASHT,UNICEF, ECMI)

- **Ministria e Arsimit,** e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2014b). *Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar. (* MASHT,UNICEF, ECMI)

- **Ministria e Arsimit,** e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2015). *Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020.* Prishtinë. http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/qa-strategy-final-shqip.pdf

- **Ministria e Arsimit,** e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2015). Udhëzimi administrativ nr. 19/2015, Për sistemimin e nxënësve të cilët kanë migruar nga viti shkollor 2014/2015 http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/ua-19-2015

- **Ministria e Arsimit,** e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). Udhëzimi administrativ nr. 1/2016, Përcaktimi i kushteve, kritereve dhe procedurave për organizimin e mësimit plotësues për nxënësit e riatdhesuar http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/01/ua-masht-nr-01-2016

- **Ministria e Arsimit,** e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016a). Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021. Prishtinë. http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf

- **Ministria e Arsimit,** e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016c). *Udhëzimi Administrativ nr.* 24/2016: *Sigurimi i cilësisë në Arsimin Parauniversitar.* Prishtinë. http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/rotatedpdf180.pdf

- **Ministria e Arsimit,** e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2018). Udhëzimi administrativ 08/2018 për krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/06/8-ua-masht-nr-08-2018-per-themelimin-dhe-fuqizimin-e-ekipeve-parandalimdhe-kbmnapu.pdf

- **Ministria e Arsimit,** e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2019). Plani i punës kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës (2019 – 2020).

- **Ministria e Arsimit,** Shkencës dhe Teknologjisë. (2017). Raport përmbledhës mbi gjetjet nga monitorimi dhe mentorimi i DKA-ve dhe shkollave, lidhur me funksionimin e EPRBMSH. https://ëëë.childrights-ks.org/site/assets/files/1408/raporti_monitorues_mbi_funksionimin_e_eprbmsh_a5.pdf

- **Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. (2010). STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN DHE ELIMINIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE NË KOSOVË 2011 – 2016.** http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_DHE_PLANI_I_VEPRIMIT_PER_PARANDALIMIN_DHE_ELIMINIMIN_E_PUNES_SE_FEMIJEVE_NE_KOSOVE_2011_-_2016.pdf

- **Ministria e Punëve të Brendshme (2017). Strategjia për riintegrimin të qëndrueshëm të e personave të riatdhesuar në Kosovë (2018-2022).** https://kryeministri-ks.net/documents/strategjia-shteterore-per-riintegrim-te-qendrueshem-te-personave-te-riatdhesuar-ne-kosove-2018-2022/

- **Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). (2011). HAPAT E ILO-IPEC PËR ELIMINIMIN E FORMAVE MË TË RËNDA TË PUNËS SË FËMIJËVE NË KOSOVË.** https://ëëë.ilo.org/ëcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/ëcms_168280.pdf

- **Qendra për Arsim e Kosovës /KEC/ (2019). Doracak i Përmbledhjes së Praktikave të mira të Zgjidhjeve Paqësore të Konflikteve mes Bashkëmoshatarëve në Shkolla.**

- **Qeverisë së Republikës së Kosovës. (2013). Rregullorja QRK- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar.** https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/06/udhezuesi-final-1.pdf

- **Qeverisë së Republikës së Kosovës. (2015). Udhëzuesi për zbatimin e Rregullores së QRK- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.** http://kec-ks.org/ëp-content/uploads/2016/05/Udhezuesi-Final.pdf

- **Hyseni,** H. (2011). Parandalimi i dhunës në shkolla. Qendra për Arsim e Kosovës – KEC.

- **Instituti Pedagogjik i Kosovës (2014).** *Fëmijët jashtë shkollës – Studim bazë për praktikat e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë***.**

- **Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016d).** *Udhëzues për vlerësimin të jashtëm të performancës së shkollës.* **IPK,** Prishtinë. http://ipkmasht.rks-gov.net/udhezuesi-per-vleresimin-e-jashtem-te-shkolles/

- **"Iniciativa e Kosovës për Integrim KOSINT 2020" . (2019). Raport Tematik në lidhje me arsyet që ndikojnë në braktisjen e shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom,** ashkali dhe egjiptian. https://kosint2020.net/site/assets/files/1457/arsyet_qe_ndikojne_ne_braktisjen_e_shkollimit_nga_nxenesit_e_komuniteteve_rom-_ashkali_dhe_egjiptian-1.pdf